



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Cilësia dhe Siguria Ushqimore”
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Anila Hoda


Prof. Magdalena Cara

Janar 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Master Profesional në "Cilësia dhe Siguria Ushqimore",
ofruar nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë,**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Agroushqimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Cilësia dhe Siguria Ushqimore"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i MASR Nr. 683, datë 12.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Regjistrimi i formës së diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit / 2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE/ /2 PAK (Viti akademik 2020-2021)
18	Numri i studentëve:	27 studentë (2020 – 2021)
19	Komente / të tjera:	-




TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional: "Cilësia dhe Siguria ushqimore", ofrohet nga Departamenti i Agroushqimit, Fakulteti i Bujqësisë dhe është hapur me Urdhër të MASR Nr. 683, datë 12.10.2018. Kohëzgjatja e studimeve është një vit akademik dhe programi i studimit përfshin 60 ECTS. Ky program studimivlerësohet në kuadër të akreditimit për herë të parë.

Departamenti i Agroushqimit ka një personel akademik me 12 punonjës, 4 Prof.asoc. 5 Dr. dhe 3 Msc. Për realizimin e këtij programi studimi, angazhohen staf akademik i brendshëm dhe i ftuar me përvojë brenda dhe jashtë vendit. Në dispozicion të studentëve, si dhe për realizimin me sukses të këtij programi studimi është një infrastrukturë bashkëkohore didaktike duke përfshirë këtu jo vetëm auditorët, por edhe laboratorët mësimorë, bibliotekën, përdorimin e internetit, si dhe të gjitha fasilitetet e tjera që mundësojnë një mësimdhënie cilësore, jo vetëm në ecurinë e zakonshme, por edhe në kushtet vështira të pandemisë.

Programi i studimit (PS) Master Profesional (MP) "Cilësia dhe siguria ushqimore" (CSU) siguron përgatitjen e specialistëve të aftë që të punojnë në të gjitha proceset teknologjike të industrisë ushqimore. Ky program ofron përgatitje profesionale të studentëve duke synuar kërkesat e tregut të punës. Kurrikula e këtij programi studimi jo vetëm nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por ajo është në përputhje me misionin e Arsimit të Lartë në vendin tonë, si edhe me Planin Strategjik të UNIKO.

Institucioni bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit. Kjo mbështetet nga mjaft marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private, si dhe me sektorin e biznesit. Në punësimin e studentëve një rol pozitiv luan Qendra e Karrierës dhe Alumni, e cila përmes organizimit të panairëve të punësimit orienton dhe mbështet të gjithë studentët e Universitetit "Fan Noli", Korçë, pra dhe ata që përfundojnë studimet në programin Master Profesional: "Cilësia dhe Siguria Ushqimore".



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të brendshëm është përgatitur nga një ekip i Universitetit "Fan Noli", Korçë, i cili përfshin anëtarë të stafit akademik, stafit mbështetës si dhe përfaqësues të studentëve. Grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) i mbështet argumentat e shkruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) në një sërë dokumenta të vëna në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përmes sistemit AMS. GVB gjykon se në të gjashtë fushat e vlerësimit, standartet janë të përmbushura plotësisht.

GVJ përbëhet nga Prof. Magdalena Cara dhe Prof. Anila Hoda. GVJ në gjithë procesin e vlerësimit të jashtëm është mbështetur nga një Kordinator Teknik, përfaqësues i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). GVJ shfrytëzoi RVB, si dhe 78 evidenca të ndryshme, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikën, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit të Agroushqimit. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor, dhe aktivitetëve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambiente të brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin studimit Master Profesional: "Cilësia dhe Siguria Ushqimore". GVJ vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet e mëposhtme:

Për fushën e parë të vlerësimit: "Ofrimi i programeve të studimit" grupi i vlerësimit të jashtëm nuk evidentoi ndonjë praktikë të mirë, dobësi, rekomandim apo afirmim. Programi i Studimit "Master Profesional": "Cilësia dhe Siguria Ushqimore" i përmbush të gjitha kriteret e vlerësimit të fushës së parë. Programi i studimit është në përputhje me misionin, statutin dhe rregulloret e Institucionit. Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme publike dhe private, aktorë të biznesit etj në funksion të realizimit të programit të studimit, kryesisht në mbështetje të formimit profesional të studentëve. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 1 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e dytë të vlerësimit: "Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit" GVJ konstaton se në programin e studimit mungojnë orët laboratorike, si dhe sasia e paktë e orëve të praktikës profesionale. Raportimi periodik i kordinatorit të programit të studimit të drejtuesi i njësisë bazë, nuk është i mbështetur në dokumentacion. Literatura mbështetëse e programit të studimit, ka nevojë për përditësime si edhe specifikime konkrete se me cilin program është përafuar duke specifikuar edhe kur ka përafime të pjesshme. Duke qenë se faqja zyrtare e institucionit nuk është aktive, shumë informacione jepen përmes rrjeteve sociale si facebook dhe GVJ konstatoi se aty paraqiten më shumë aktivitete të fakultetit dhe departamentit, sesa të Programit të Studimit. GVJ konstatoi se në kontekstin e rishikimit të programit të studimit janë bërë vetëm ndërrime të kategorizimit të moduleve dhe ndryshim të numrit të ECTS-ve, të cilat në ndonjë rast i gjykojmë të paargumentuara nga Institucioni, siç është ulja e ECTS nga 12 në 9 për Tezën e diplomës/provim diplome. GVJ rekomandon (i) përfshirjen e orëve laboratorike, në modulet e formimit profesional, rritjen e orëve të praktikës profesionale deri në 150 (6 ECTS); (ii) dhënien e informacionit në rrugën zyrtare, si parësore e më tej përmes përdorimit të rrjeteve sociale; (iii) ndryshimet që bëhen në kontekstin e rishikimit të programit të studimit të jenë të argumentuara dhe jo thjesht fakt i kryer. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 2 përmbushet kryesisht.**

Për fushën e tretë të vlerësimit: "Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat" GVJ Por GVJ konstatoi (i) paqartësi në bërjen publike të raporteve të analizës vjetore, si dhe të promovimit të

shembujve më të mirë (ii) disakordancë të ngarkesës mësimore dhe shumë module të mbuluara nga një person i vetëm megjithëse me kualifikim "Nivel Master"; (iii) mosfunksionim të sistemit elektronik (ESSE3); (iv) mospërfshirje të partnerëve në faza të ndryshme të programit të studimit (v) ngarkesë të lartë të sekretarisë e cila nuk ka të dokumentuar asnjë kontroll të brendshëm për vlerësimin e situatës në rastet e ndonjë gabimi eventual apo ankimeve të studentëve. GVJ sugjeron (i) gjetjen e mekanizmave të vlerësimit dhe implementimin institucional të tyre për të përmirësuar procesin e mësimdhënies (ii) përditësimin e literaturës në përdorim, recensimin e saj në mënyrë të rregull dhe të panashëm, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në përdorim (iii) vënien e theksit tek kualifikimet profesionale më shumë se tek ato shkencore si për stafin ashtu edhe për studentët mbështetur nga fakti që Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm biznese profesionale. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 3 përmbushet kryesisht.**

Për fushën e katërt të vlerësimit: "Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit" GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit janë transparente. Infrastruktura, mjediset mbështetëse për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe formimit praktik të studentëve është e përshtatshme. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi disa mangësi: (i) mungesën e bibliotekave digjitale online, e cila ka funksionur për një periudhë shumë të kufizuar, (ii) mungesën e informacionit mbi përditësimin e fondit të literaturës së bibliotekës në funksion të programit të studimit; (iii) mosfunksionimin e faqes zyrtare të institucionit, si dhe (iv) të sistemit të brendshëm të administrimit të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të institucionit. Grupi i vlerësimit të brendshëm rekomandon riaktivizimin e faqes zyrtare të Institucionit, të sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit si dhe ofrimin e mundësive për stafin dhe studentët në bibliotekat on-line, të lidhura me programin e studimit. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 4 përmbushet kryesisht.**

Për fushën e pestë të vlerësimit: "Studentët dhe Mbështetja e tyre", GVJ nuk evidentoi ndonjë praktikë të mirë, dobësi, rekomandim apo afirmim. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 5 përmbushet plotësisht.**

Për fushën e gjashtë të vlerësimit: "Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit" GVJ konstatoi (i) mungesën e raporteve analitike të veçanta vjetore për vlerësimin e programit të studimit; (ii) mungesën e raporteve që nxjerrin në pah vlerësimet e studentëve, stafit akademik, alumni, grupet e ndryshme të interesit etj, të përfuara përmes sondazheve, pyetësorëve, intervistave etj. (iii) mungesën e një plani masash për adresimin e problematikave; (iv) mospërfshirjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit. GVJ rekomandon (i) kryerjen e analizave, vlerësimeve analitike e krahasuese, të veçanta dhe jo në grup të programeve të studimit, në të gjithë elementët e tyre, duke përdorur të gjitha burimet e mundshme të informacionit, si dhe mendimet e sugjerimet që mund të përftoheshin nga studentët, stafi akademik, alumni etj. në funksion të përmirësimit të cilësisë; (ii) vlerësimet duken të dokumentohen të përfshijnë rezultatet të pritshme, rezultate të vlerësimit si dhe plan masash për adresimin e mangësive (iv) rezultatet e vlerësimit të bëhen publike, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. **Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se Fusha 6 përmbushet kryesisht.**

Vlerësimi i përmbledhur

Grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit, se standartet për programin e studimit Master profesional "Cilësia dhe Siguria Ushqimore", ofruar nga Fakulteti i Bujqësisë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, **përmbushen kryesisht.**

Më datë 11.01.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 04/01 Prot., datë 11.01.2022, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli

komentet, përmes sistemit AMS, më datë 14.01.2022 dhe me shkresë Nr. 1532/04 Prot., datë 14.01.2022.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Pranojmë që është një lapsus nga ana jonë në vlerësimin e fushës 2 "Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit", si dhe fushës 3 "Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat", duke e vendosur në tabelën përmbledhëse të secilës fushë "Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II dhe III" vlerësimin "Përmbushet plotësisht". Kapitulli i parë "Përshkrim i procesit të vlerësimit të jashtëm", si dhe tabela përmbledhëse në fund të raportit janë korrekt, sipas vlerësimit tonë të argumentuar. Në fushën 2, janë 5 standarte të plotësuara "kryesisht" dhe 2 të plotësuara "plotësisht", ndërsa në fushën 3, janë 4 standarte të plotësuara "kryesisht" dhe 5 të plotësuara "plotësisht". Pamvarësisht nga sa më sipër, dëshirojmë t'ju sqarojmë se vlerësimi i një fushe nuk është një "matematikë" e thjeshtë, përse i përket plotësisht të standarteve brenda fushës, por në tërësinë e vet i referohet komenteve si dhe rekomandimeve të hartuara nga GVJ. Për të dy fushat GVJ ka komentuar, si dhe sugjeruar një numër rekomandimesh, në fund të raportit të cilave, Ju nuk i jeni adresuar, por vetëm një pjese të komenteve për të cilat GVJ shpjegon si më poshtë:

- GVJ është i qartë përse i përket procedurave që ndjek Universiteti i Korçës për ndryshimet në planin mësimor, të një programi studimi (shtojca 2.15). Megjithatë, shpjegimet për ndryshimet në planin mësimor në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", nuk janë plotësisht të justifikuar:
- Dëshirojmë të theksojmë se të dy VKM-të (nr 41 dhe 879) nuk kanë ndryshime në lidhje me elementët e programit të studimit Master profesional.
- Kalimi i një moduli nga një kategori në tjetrën, konkretisht "Administrimi i Karrierës dhe aftësi në sipërmarrje" nga kategoria C në D, nuk bëhet vetëm për të plotësuar matematikisht ECTS, apo përqindjet e përcaktuara në VKM, por nga brendia e tij.
- Tezë diplome/provim diplome (6-12 ECTS) është brenda kufijve të përcaktuar nga VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, si dhe me VKM Nr 879, datë 18.12.2019 (si më sipër) të cilës i referoheni Ju, dmth brenda 10 - 20% të ECTS.

Nga sa më sipër **raporti në këtë pike nuk ndryshon.**

2. GVJ është në dijeni të metodave të reja të mësimdhënies, siç shkruhet dhe në RVB "Personeli akademik përdor në funksion të mësimdhënies platformën on-line (e-learning) Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams (Shtojca 2.17)". Ne shprehemi për paqartësi në metodat e reja të mësimdhënies, pasi kjo gjë nuk na u evidentua në takimet me stafin akademik, gjatë vizitës tonë në institucionin tuaj. GVJ bie dakord ta heqë këtë rekomandim, si rrjedhojë **raporti në këtë pikë ndryshon**, por kjo nuk ndryshon vlerësimin përfundimtar të fushës 3.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Cilësia dhe Siguria Ushqimore”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit (PS) Master Profesional (MP) “Cilësia dhe siguria ushqimore” (CSU) siguron përgatitjen e specialistëve të aftë që të punojnë në të gjitha proceset teknologjike të industrisë ushqimore. Ky program ofron përgatitje profesionale të studentëve duke synuar kërkesat e tregut të punës. Kurrikula e këtij programi studimi jo vetëm nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por ajo është në përputhje me misionin e Arsimit të Lartë në vendin tonë, si edhe me Planin Strategjik të UNIKO (Shtojca 1.3).
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Ruajtja dhe konsolidimi i vlerave akademike është e lidhur me politikat e Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL), ato janë në përputhje me interesat kombëtare dhe transmetohen vertikalisht në Departament si edhe në programet e tij të studimit.</p> <p>Mbështetur në listën kombëtare të profesioneve, kompetencat e formimit të studentëve të programit të studimit CSU, janë përfshirë në rregulloren e programit të studimit duke synuar gjithashtu edhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare (Shtojca 2.3, Rregullorja e njësisë bazë agroushqim) dhe (Shtojca 2.5. Rregullorja e programit të studimit 2020-2021). Informacioni i vënë në dispozicion për GVJ e mbështet totalisht këtë.</p> <p>Programi CSU synon të jetë në një hap me zhvillimet bashkëkohore dhe tendencat që vërehen sot në fushën e cilësisë ushqimore dhe të arritjes së parametrave të nevojshëm për të përhapur konceptet bashkëkohore të teknikave moderne në këtë fushë.</p> <p>Nga intervistat e realizuara gjatë ditëve të vizitës, nga dokumentat e vëna në dispozicion në sistem, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) thekson se programi studimit MP CSU, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Universiteti “Fan S. Noli” si IAL, synon të ofrojë vlera të larta profesionalizmi, qytetarie si edhe vlera akademike e kulturore.</p>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin e arsimit të lartë, si dhe me politikën udhëheqëse të Universitetit, të reflektuar në statutin e UNIKO (Shtojca 1.1. Statuti i UNIKO.pdf), të miratuar me Urdhërin Nr. 56, datë 08.02.2018 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si edhe (Shtojca 1.1.1 Draft statuti i ndryshuar i universitetit Fan S. Noli). Programi përkon me strategjitë e aplikuara për zhvillimin ekonomik të rajonit dhe të vendit.

Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Cilësia dhe siguria ushqimore janë indikatorë kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Ky program studimi i hartuar me këtë drejtim është një kurrikul në përputhje me kapacitetet e brëndëshme, ekperiencat më të mira kombëtare dhe rajonale si dhe në nxitje të zhvillimit ekonomik lokal të rajonit të Korçës dhe jo vetëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>PS MP CSU është në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2016-2020) dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2021-2026), si dhe kërkesat e Rregullores së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Për programin MP CSU, Emërtimi, Struktura dhe Përmbajtja, përmbushin kërkesat e shkruara në Nenin 2, dhe Kreun III të Statutit të UNIKO (2018). Po kështu disa dokumente strategjike në nivel akademik dhe lokal, që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural, i japin një përparësi formimit profesional në agroushqim dhe veçanërisht në prodhimin e produkteve ushqimore.</p> <p>Duke u bazuar në dokumentat strategjike të mësipërme (Shtojca 1.1), UNIKO i ka dhënë një rëndësi të madhe industrisë së përpunimit të produkteve ushqimore. Siç përmendet edhe në RVB: duke mbështetur hapjen e programeve të studimit të lidhura me këtë disiplinë, si dhe rritjen e peshës së moduleve në fushën e agroushqimit që zhvillohen në programe studimi të tjera në UNIKO.</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga kontrolli i dokumentacionit bazë: Statuti dhe rregullorja e UNIKOs shihet qartë se ato përcaktojnë drejtimit prioritar akademike të PS si edhe demonstrojnë që PS hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të prioriteteve në lidhje me mësimdhënien dhe tregun e punës. Ky program studimi synon të ofrojë njohuri që t'i shërbejnë përmirësimit të qëndrueshmërisë sociale, industriale dhe ekonomike.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emëtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e PS ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të UNIKO. Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 18, 23, 35, 69 dhe 75; të ligjit Nr.80/2015 dt. 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25, pika 7 si dhe udhëzimi Nr.31, dt. 29.12.2017, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga IAL-të”, u miratua nga Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nga Senati Akademik dhe Asambleja e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë bazohet hapja e programit të ciklit të dytë të studimit “Master

	<p>profesional” në “Cilësia dhe siguria ushqimore” në Departamentin Agrorshqim, në Fakultetin e Bujqësisë. (Shtojca 2.1), (Shtojca 2.21).</p> <p>Departamenti i Agrorshqimit ka një staf të motivuar për t’u kualifikuar për të rritur kompetencat në përmbushjen e vizionit të UNIKO. Programi i studimit organizohet në module dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Programi realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master profesional” në “Cilësia dhe siguria ushqimore” në Departamentin Agrorshqim, në Fakultetin e Bujqësisë, Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Programi i studimit në UNIKO hartohet nga njësi bazë dhe i paraqitet për miratim Senatit Akademik (Shtojca 1.11).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

Standardi I.3

Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit, master profesional "Cilësia dhe Siguria Ushqimore" ka karakter profesional. Ai zhvillohet në 1 vit akademik dhe realizohet në 60 kredite.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.5) janë të përcaktuara objektivat dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundimin e tij.</p> <p>Kjo rregullore përcakton që: objektivi kryesor i programit “Master profesional” në “Cilësia dhe siguria ushqimore” i cili është mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë është t’u ofrojë studentëve të ciklit të parë të studimeve një mundësi zgjedhjeje më praktike për kualifikim të mëtejshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat</p>	<p>Sipas rregullores (Shtojca 2.5); në një vëzhgim të tregut të punës, konkretisht në institucionet e sistemit të ushqimit dhe të bujqësisë në Rajonin e Korçës, studimi paraprak mbi nevojat e tregut të punës, rezultuan në faktin se ka një mungesë të ndjeshme të specialistëve të formuar dhe të diplomuar në këtë specialitet në nivelin Master. Nga ana tjetër, politikat aktuale qeverisëse në sektorët e ushqimit, bujqësisë dhe sidomos agropërpunimit, standartizimit të produkteve ushqimore, bujqësore dhe blegtorale, si edhe të kontrollit të cilësisë të ushqimeve, kërkojnë specialistë që kanë njohuri të thelluara në fushën e cilësisë dhe sigurisë ushqimore si një sektor shumë jetik dhe mjaft i rëndësishëm për</p>

dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	ekonominë tonë dhe ruajtjen e shëndetit të njerëzve. Këto politika kanë zgjeruar spektrin e shërbimeve në këto sektorë dhe shtojnë nevojat për cilësi më të lartë të kualifikuar në këto shërbime.
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	GVJ vlerëson se ky program studimi, pavarësisht që është i ri, ai ka shfrytëzuar edhe përvojën e programeve të ngjashme brenda vendit duke krijuar një qëndrueshmëri, traditë dhe vazhdimësi. Struktura e kurrikulës së programit, rezultatet dhe objektivat e të nxënit për studentët të dhëna në modulet, janë në funksion dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme të Programit. Sa më sipër rezulton se ky program garanton plotësisht formimin teorik dhe praktik të specialistëve me aftësi të larta në fushën përkatëse, si një domosdoshmëri themelore e tregut në ditët e sotme. GVJ mendon se ky kriter përgjithësisht përmbushet mirë.
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Programi i studimit MP CSU është relativisht i ri, nga kërkimet tona në internet, Master në ushqim zhvillohet nga shumë universitete evropiane, amerikane dhe më gjerë. Si grup vlerësimi nuk arritëm të gjejmë shkallën e përafërimit të programeve lëndore me programet e ngjashme të ofruara nga institucionet ndërkombëtare. Po kështu edhe në RVB nuk cilësohet ky aspekt. Në lidhje me transferimin e studimeve apo punësimin e studentëve në tregun ndërkombëtar mendojmë që fusha e ushqimit është një nga fushat atraktive. Për këtë arsye studentët masterianë në CSU janë kompetentë për kërkesat e tregjeve të punës Brenda dhe jashtë vendit.
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikave të mira të vendeve evropiane.	UNIKO ka një përvojë disavjeçare në fushën e edukimit duke shfrytëzuar praktikave më të mira ndërkombëtare. Masteri në shqyrtim përputhet me kërkesat e Masterit profesional (Master i nivelit të parë) të Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK, 2014), të cilat janë në përputhje me VKM në fuqi (VKM 41/2017) si edhe direktivat e BE. Sa më sipër citohet edhe në të dhënat e programit të studimit Rregulloren (Shtojca 2.5) si edhe të gjithë informacionin shtesë në Dosjen përkatëse në ASCAL.
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Nga shqyrtimi i dokumentave si edhe intervistat GVJ mendon se PS MP CSU përgjithësisht përfshin aftësim profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e tij, si dhe në direktivat ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Ajo që doli në pah nga intervistat me personelin akademik ishte se, aftësimi profesional dhe praktikave profesionale gjatë pandemisë të shkaktuar nga Covid 19, janë zhvilluar virtualisht dhe jo në terren.
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master	Nga kontrolli i dokumentacionit (Shtojca 2.8, Programet lëndore të programit të studimit), RVJ nuk konstaton që të ofrohen lëndë ose module në gjuhë të huaj. Kjo si në Rregulloren e Programit, dhe në Syllabuset lëndore. Sygjerohet që kjo

profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	është një çështje shumë aktuale dhe kërkesë e kohës dhe e tregjeve të punës Brenda dhe jashtë vendit. Sa më sipër Departamenti duhet të marrë në konsideratë mundësinë e zhvillimit të mësimin dhe në gjuhë të huaj, angleze, ose tjetër gjuhë me interes për tërheqjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	PS MP CSU nuk është rasti në fjalë. GVJ mendon se zhvillimi i këtij Programi përbën një qëndrueshmëri për shkak të misionit, qëllimit dhe objektivave realë të tij. Specialistët e masteruar në këtë program përbëjnë një personel të kualifikuar dhe të lidhur me në një sektor shumë të rëndësishëm për Qarkun e Korçës dhe jo vetëm, atë të sigurimit të cilësisë në ushqimin e përditshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Duke ju referuar dokumentave të paraqitura në ASCAL nga GVB; Unversiteti i Korçës “F.S.Noli” i themeluar 30 vite më parë me VKM 230/1992 (Shtojca 1.3.1) është i akredituar nga ASCAL, me në vitin 2017 deri në 30/09/2022 (https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara), me Vendim të BA 65/2017. Në vite ka një numër të konsiderueshëm studentësh nga gjithë Shqipëria dhe në vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 3,334 studentë.</p> <p>UNIKO mban Urdhërin “Naim Frashëri” (2001) dhe dekoratën “Nderi i Kombit” (2015).</p> <p>UNIKO përbëhet nga 4 fakultete, 15 departamente dhe 28 njësi administrative, zhvillon ka sot rreth 60 Programe studimi (54 aktivë dhe 6 jo aktivë) (Shtojca 1.3.1) të miratuara, 7 programe profesionale (2 vjeçare), 26 BA, 21 MP, 3 MS, 1 PhD, 9 prej tyre të akredituar nga Bordi i Akreditimit, dhe 13 në proces akreditimi.</p> <p>UNIKO ka 127 marrëveshje ndërkombëtare me partnerë homologë në vendet e Ballkanit dhe Europës (Shtojca 1.3.1); është pjesë e rrjeteve ASCEC, AUF, UNIMED, AURORA CDS, dhe BALKAN UNIVERSITY ASSOCIATION; është pjesë e 11 projekteve ndërkombëtare Erasmus+ KA2, dhe 4 marrëveshje mobilitetesh Erasmus+ KA1. Ka Bibliotekë të ndarë në 5 mjedise, për secilin Fakultet, me 30,000 libra dhe 12,000 tituj gjithsej, dhe lidhje me rrjetet digjitale ProQuest dhe U Library, të cilat ofrojnë online 170,000 libra dhe 70 milionë tituj publikimesh të ndryshme.</p> <p>Ka 9 laboratorë mësimorë dhe shkencorë (Shtojca 1.3.1), ku bëjnë pjesë</p>

	<p>laboratorët e Agrokimisë, Pedologjisë, Kimisë dhe Kimisë Analitike, Biologjisë dhe Biologjisë Molekulare, dhe Informatikës, Mbrojtjes së Bimëve, Pemtarisë, Perimtarisë dhe Fitoteknisë, të gjithë këta me rëndësi në zhvillimin e Programit nën shqyrtim. DAGU bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE) me sipërfaqe prej 19 ha, direkt nën varësi të UNIKO, me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Korçë, dhe me sipërmarrje të ndryshme me drejtim bujqësor.</p> <p>Duke vlerësuar sa më sipër GVJ mendon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga kontrolli i dokumentacionit GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e PS MP CSU është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore (Fakulteti i Bujqësisë), që është përgjegjës për zhvillimin e Programit dhe është pjesë e UNIKO që nga themelimi (1992). Ky fakultet është gjithashtu vazhdim i Institutit të Lartë Bujqësor të Korçës, që nga viti 1971. Fusha e studimit, përcaktohet qartë në Rregulloren e Fakultetit.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e Programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Agroushqimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve Kombëtare dhe Europiane.</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk është rast i tillë Programi në shqyrtim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të

studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	DAGU ka një personel akademik me 12 punonjës, 4 Prof.asoc. 5 Dr. dhe 3 Msc. Stafi ka kualifikimet e nevojshme për të dhënë modulet sipas CV të paraqitura, por ajo që shihet problematike është niveli i kualifikimit “Master” që jep mësim në “Master” dhe jo vetëm kaq por ka një peshë të konsiderueshme në kurrikul. Nga dokumentacioni në dispozicion dhe nga vizita monitoruese u pa që: përgjegjësi i DAGU ndjek ecurinë e Programit në bashkëpunim me Dekanatin e FB, me Sekretarinë Mësimore të FB, me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Vlerësimi Institucional sipas (Shtojca 1.5).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkuara në rang institucional, janë edhe në ndihmë të PS MP CSU. Ato janë me disa institucione analoge brenda vendit tonë; me institucione shtetërore, si edhe me aktorë të biznesit.
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me Qarkun Korçë, Bashkitë e Korçës, Pogradecit, Devollit, Ersekës dhe Maliqit dhe me institucione të tjera shtetërore (Shtojca 2.10). Mbështetur në këto marrëveshje studentët të Programit kryejnë praktika mësimore dhe profesionale pranë tyre.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	DAGU ka marrëveshje dhe bashkëpunime me disa biznese në fushën e ushqimit dhe agropërpunimit ku edhe zhvillohen pjesa më e madhe e praktikave mësimore dhe profesionale. Sa më sipër janë paraqitur në Shtojcën 3.5 si edhe në Udhëzuesin për Praktikën Profesionale (Shtojca 3.21). Një Raport më i detajuar mbi përfitimet e Programit nga bashkëpunimi /marrëveshja me QTTB, Korçë është dhënë në Shtojcën 3.6.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mtejshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.	Nga intervistat me personelin akademik si edhe nga Raporti del që UNIKO zhvillon kurse kualifikimi në nivele profesionale për specialistë të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Korçë, QTTB Korçë, për fermerët kultivues dhe përpunues të mollës, patates, fasules etj., të Qarkut Korçë. Sa më sipër është një indikator i mirë dhe nxitës për rritjen e niveleve të kualifikimit dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit.
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të	Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti i Agroushqimit për PS MP CSU nënshkruan një numër të lartë marrëveshjesh bashkëpunimi të cilat mendohet të jenë në ndihmë të drejtpërdrejtë të studentëve të këtij programi. Departamenti Agroushqimit ka paraqitur Analizën Vjetore të veprimtarisë së

realizimit të programeve të studimeve.	njësisë bazë (Shtojca 3.8) për punën mësimore dhe kërkimore në të cilën merren në analizë edhe përfitimet nga bashkëpunimet e ndryshme. Kjo në formën e arritjeve në procesin mësimor dhe atë kërkimor (punë diplome, doktorime, publikime dhe pjesëmarrje në konferenca etj.).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri I Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Cilësia dhe siguria ushqimore”, është i organizuar në lëndë e module të cilat janë të vlerësuara me kredite. Kjo është mbështetur sipas legjislacionit në fuqi. Sa më sipër janë të përcaktuara në rregulloren e studimeve të Universitetit “Fan S Noli” (Shtojca 1.2) dhe Rregulloren e Programit të studimit “Master professional” “Cilësia dhe siguria ushqimore” (Shtojca 2.5).</p> <p>Sipas Shtojcës 2.5, Plani Mësimor i Programit është i organizuar në 12 lëndë plus praktika profesionale. Nga këto:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 lëndë e kategorisë A me 5 kredite, - 5 lëndë të kategorisë B me 22 kredite, - 6 lëndë të kategorisë C me 19 kredite, - Praktikë Profesionale, kategoria D me 2 kredite - Punë Diplome me 12 kredite. <p>Lëndët janë të ndara në Module (Leksione, Seminare ose/dhe Laboratore), të vlerësuara me Kredite gjithsej 60, të cilat zhvillohen brenda 1 viti (2 semestra ose 30 javë mësimore). Programi është i pajisur edhe me Suplementin e diplomës. Programi përmbledh gjithësej 1500 orë nga të cilat: 695 orë në auditor /805 orë jashtë auditorit.</p> <p>GVJ konstaton se mungojne orët e praktikave laboratorike. Tipet e lëndëve, volumi i tyre në kredite dhe shpërndarja e moduleve përkatëse në semestra saktësohen në përputhje me kërkesat e VKM 41/2017.</p>

	GVJ sygjeron që praktika profesionale të ketë minimumi 6 Kredite, 150 orë ose 6 javë pune sidomos në ndërmarrjet ushqimore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Programi i studimit CSU si program i ciklit të dytë synon formimin e shprehive në profilin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore me synim që të përshtasë dijet e marra për tregun e punës në rajon.</p> <p>Ky program ka një kurrikul të hartuar në përputhje me nevojat e tregut për specialistë të kësaj fushe brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit (Shtojca 2.7) përfshin disiplina të formimit të përgjithshëm, disiplina të formimit karakterizues dhe disiplina formuese me zgjedhje, aftësi komunikuese, praktika profesionale dhe teza e diplomës të cilat realizojnë 60 kredite.</p>
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>PS MP CSU si program i ciklit të dytë jep njohuri të përparuar dhe profesionale në fushën e ushqimit, cilësisë dhe sigurisë së tij.</p> <p>Sa më sipër ofrohet përmes mësimëve teorike leksione dhe seminare si edhe praktikave profesionale.</p> <p>Njohuritë që ky program ofron në lidhje me sigurinë ushqimore e cila është edhe garancia që ushqimet që ne konsumojmë jo vetëm të mos na shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndet por edhe të jenë të shëndetshme janë nga më praktiket që tregu kërkon sot.</p>
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Duke u nisur nga konsideratat teorike dhe praktike të dokumentacionit në dispozicion si edhe të intervistave me personelin e programit të studimit, gjykojmë me shumë vend emërtimin dhe strukturën e tij. Aftësitë dhe kompetencat e avancuara të elementeve përbërës dhe konceptualë, janë të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse që ofron kjo disiplinë. Siguria e ushqimit dhe cilësia e ushqimit kanë lidhje të ngushtë dhe në shumicën e rasteve trajtohen si e njëjta gjë. Siguria e ushqimit i referohet prodhimit, përpunimit, transportit dhe ruajtjes së ushqimit në mënyrë që rreziku nga sëmundjet prej ushqimit të jetë sa më i ulët. Ndërsa, cilësia e ushqimit ndërlidhet me karakteristikat e ushqimit të pranueshme për konsumatorët. Kjo përfshin faktorët e jashtëm si pamja (madhësia, forma, ngjyra, shkëlqimi dhe konsistenca); cilësia dhe aroma; faktorë të tillë si standardet e klasave (p.sh. të vezëve) dhe të brendshme (kimike, fizike, etj.).</p> <p>Njohuritë, aftësitë, kompetencat e avancuara në fushën profesionale janë të listuara në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.5). Aty thuhet që: <i>Në përfundim të këtij programi studentët fitojnë njohuri dhe aftësohen që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të jenë specialistë të aftë dhe të kualifikuar për të prodhuar produkte cilësore, nëpërmjet hartimit të teknikave bashkekohore jo vetëm në prodhimin e tyre por edhe për çertifikimin dhe ruajtjen e këtyre produkteve bujqësore.</i> • <i>Të njohin tiparet karakteristike të rajonit dhe të vënë në dispozicion të fermerëve materiale informuese për kërkesat që ka sot tregu për produkte të cilësisë së lartë.</i> • <i>Të jenë specialistë të lartë dhe të kualifikuar për t'u përballur me sfidat e</i>

	<p><i>kohës në drejtimin e ndermarjeve të agropërpunimit dhe certifikimit të këtyre produkteve.</i></p> <p>GVJ vlerëson trajtimin e këtyre elementeve në mënyrë profesionale dhe praktike.</p>			
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Lidhur me strukturën dhe elementët përbërës të tij, Programi është përgjithësisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM, 41/2018; VKM 879/2019; U1-MASR/2020). Programi ka ngarkesat përkatëse të shpërndara sipas elementëve të zhvillimit të njohurive, leksione, seminare, laboratore, praktika dhe Tezë/Provim Diplome.</p>			
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në (Shtojcën 2.5) jepen informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, si dhe një pasqyrim i hollësishëm përsa i takon përmbajtjes së praktikave, seminareve, si dhe literaturat përkatëse.</p> <p>Po ashtu jepen të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM 41 (i ndryshuar) si dhe syllabuset e detajuara për secilën lëndë.</p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Sipas dokumentacionit (Shtojca 2.5 & 2.7) shihet që programi është i organizuar në lënde ose module. Ngarkesa në kredite e çdonjërit nga modulet merr në konsideratë volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore. Po kështu ka kredite të dedikuara për praktikën profesionale, pavarësisht se raporti i tyre ka nevojë për përmirësim. Sa më sipër është në përputhje me kërkesat ligjore, VKM përkatëse, si edhe me direktivat evropiane.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			√	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Bujqësisë dhe Departamenti i Agroushqimit janë përgjegjëse për programin e studimit CSU. Ky PS përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Në përputhje me Ligjin 80/2015, UNIKO është akredituar nga ASCAL, me Vendim të BA 65/2017 deri në 30/09/2022.</p> <p>https://www.ascal.al/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara</p> <p>Kjo mbështetet edhe në gjithë dokumentat e Strukturës organizative, Statutit dhe Rregullores së UNIKO, si edhe mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore, Fakulteti i Bujqësisë, si dhe Njësia bazë, Departamenti i Agroushqimit përmbushin detyrimet ligjore përkatëse si për organizimin dhe strukturën</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 16

	akademike (FB & DAGU), dhe për numrin dhe nivelin e kualifikimit (DAGU). Zhvillimi i Programit koordinohet nga Përgjegjësi i DAGU, i cili informon vazhdimisht titullarin e FB.																																							
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Në RVB thuhet që: njësia përgjegjëse për programin “Cilësia dhe siguria ushqimore” departamenti i Agroushqimit (DAGU), është një prej departamenteve të Fakultetit të Bujqësisë në UNIKO. Ky departament përmbush kriteret pasi ka në përbërje sipas Shtojcës 4. Tabelat përmbledhëse të programit të studimit; 13 personel akademik për vitet akademike (2019 – 2020 dhe 2020 – 2021) përkatësisht PAE 11 dhe 10 si edhe PAK 2 dhe 3. Kualifikimet janë sipas tabelës më poshtë.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Departamenti i Agroushqimit</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof Dr</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>4</td> <td></td> <td>3</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr ne process</td> <td></td> <td></td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td></td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>11</td> <td>2</td> <td>10</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, si edhe takimeve gjatë vizitës në institucion, rezultoi se drejtuesja e GVB është me nivel kualifikimi Master. Ajo mbulon në këtë program studimi disa module duke qenë vetë master.</p>	Departamenti i Agroushqimit	2019-2020		2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof Dr	0	1	0	1	Prof.As.Dr	4		3	0	Dr	4	1	4	1	Dr ne process			0	0	Msc	3		3	1	Total	11	2	10	3
Departamenti i Agroushqimit	2019-2020		2020-2021																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK																																				
Prof Dr	0	1	0	1																																				
Prof.As.Dr	4		3	0																																				
Dr	4	1	4	1																																				
Dr ne process			0	0																																				
Msc	3		3	1																																				
Total	11	2	10	3																																				
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse e PS përmbush përgjithësisht detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore duke ushtruar kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit shkencor, siç përcaktohet edhe në rregulloren e studimeve të UNIKO (Shtojca 1.2) dhe të programit “Cilësia dhe siguria ushqimore” (Shtojca 2.5).</p>																																							
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Fakulteti dhe departamenti për PS MP CSU ka angazhuar personel ndihmës akademik për të realizuar praktikatat mësimore të cilat zhvillohen në kuadër të kurrikulës së miratuar nga departamenti.</p> <p>Personeli ndihmës akademik ka kualifikimin dhe përkushtimin e duhur për ta realizuar atë sipas kërkesave të pedagogëve drejtues të modulit, të cilët japin udhëzimet teorike dhe praktike dhe sipas intervistave asistojnë në realizimin e tyre.</p>																																							
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në kuadër të akreditimit të programit të studimit, njësia bazë ka ngritur një grup pune për vlerësimin e cilësisë dhe për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe dosjes shoqëruese (Shtojca 3.3).</p> <p>Në zbatim të VKM, nr 531, datë 11.09.2018, departamenti i Agroushqimit në mbledhjen e datës 13.02.2020, Vendimi 110 ka zgjedhur koordinatorin e programit të studimit (Shtojca 2.11).</p> <p>Kordinatori i programit të studimit ka titullin akademik Prof.As.Dr, ndërsa Grupi i Vlerësimit të Brendshëm drejtohet nga personel akademik me nivel Master.</p>																																							

Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Sipas kërkesave standarte të akreditimit koordinatori i programit duhet të raportojë në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumentojë çdo informacion që lidhet me programin e studimit. Sa më sipër u pohua që raportohej por nuk u gjet ndonjë dokument i dedikuar me përjashtim të analizave vjetore të përgatitura për të gjithë departamentin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia kryesore dhe bazë nga e cila varet ky PS i ciklit të dytë i disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Nga dokumentat e vëna në dispozicion shihet se në tërësinë e tyre këto kritere përgjithësisht përmbushen. Dosja e Programit është e plotë, duke filluar nga Rregullorja e Programit (Shtojca 2.5), Plani Mësimor (Shtojca 2.7), Syllabuset lëndore (Shtojca 2.8), etj. Përmbajtja e Programit rishihet për vit, përgjithësisht ka patur ndërrime të kategorizimit të moduleve si edhe ndryshme të nivelit të krediteve të disa lëndëve. Mbi shikueshmërinë e këtyre dokumenteve nga jashtë në faqen zyrtare të UNIKO (https://www.unkorce.edu.al/) GVJ e rithekson që nuk është e mundur për momentin. Përmbajtjen e programit të studimit dhe cilësinë e tij GVJ do ta trajtojë edhe në lidhje me literaturën e cila mendojmë se ka nevojë për përditësime si edhe specifikime konkrete se me cilin program është përafuar duke specifikuar edhe kur ka përafime të pjeshme.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Sipas rregullores së programit të studimit, veprimtaritë formuese të programit të studimit përfshijnë: lëndë bazë; lëndë karakterizuese; lëndë ndërsipilnore/integruese; lëndë plotësuese; detyrime përmbyllëse, dhe provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës. Nga shqyrtimi i detajuar i kurrikulës dhe syllabuseve, paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar) por jo e laboratoreve. Dokumentat mbështetëse janë: Rregullorja e programit të studimit master profesional, Cilësia dhe siguria ushqimore (Shtojca 2.5), Kurrikula dhe Plani Mësimor (Shtojca 2.7).
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit MP “Cilësia dhe Siguria Ushqimore” është i organizuar në lëndë e module, ato janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian si edhe të ndara në vite e semestra. Numri i përgjithshëm i njësive lëndore është 14, të organizuara në module duke përfshirë 1 lëndë të praktikës profesionale dhe 1 modul të tezës së diplomës. Ngarkesa në kredite e çdonjërit nga modulet merr në konsideratë volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore. Minimalisht çdo 25 orë në auditor dhe studim individual vlerësohet me 1 kredit. Viti i studimit është organizuar në 60

	kredite me nga 30 kredite për çdo semester.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Nga kontrolli i dokumentacionit rezultojnë që Departamenti i Agroushqimit i ka të dokumentuara të gjitha programet e lëndëve (syllabuset) e moduleve që zhvillohen në programin e studimit “Cilësia dhe Siguria Ushqimore” (Shtojca 2.5). Ato janë përditësuar sipas formatit të VKM 41 dhe pasqyrojnë kodin e etikës (Shtojca 1.20) dhe të gjithë komponentët mësimore. Në RVB theksohet që: <i>duke konsideruar periudhën 3-vjeçare të raportimit për efekt të akreditimit, Departamenti i Agroushqimit disponon edhe syllabuset e mëparshme sipas formatit të UNIKO, që është më i detajuar sa i takon përmbajtjes së praktikave dhe seminareve.</i> Nga intervistat u rikonfirmua që fillimisht Programi i studimit miratohet në departament dhe më pas në Senatën akademik. Ai përmban informacione të plota për temat e leksioneve, seminarët, detyrat dhe projektet kurse si edhe ngarkesat e praktikës profesionale për secilën lëndë. Dosja e plotë e programit të studimit të CSU gjendet në Rregulloren e programit të studimit. (Shtojca 2.5).
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sipas rregullores së DAGU, ai përcakton strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit “CSU”. Këtu përfshihet edhe rregullimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Sikurse doli gjatë takimeve, gjithashtu edhe është theksuar në RVB; Departamenti Agroushqimit administron një faqe në rrjetin social Facebook, e cila përdoret periodikisht para periudhës së regjistrimeve për promovimin dhe informimin e maturantëve mbi programin e studimit. Njëherazi përdoret gjatë vitit akademik jo vetëm për informimin e studentëve në mënyrë dinamike, por edhe për pasqyrimin e gjithë aktivitetit të departamentit. Gjithashtu përmbajtja e planit mësimor u bëhet e njohur studentëve sapo fillojnë studimet. Syllabuset e moduleve mësimore u bëhen të njohur studentëve nga pedagogët në fillim të çdo moduli mësimor. Ato janë të miratuara dhe depozituara në departament. Kështu, studentët njihen jo vetëm me kreditet por edhe me formën e kontrollit të dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formues dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimor të programit të studimit. Nga kontrolli i faqes në facebook na rezultojnë se aty paraqiten më shumë aktivitete të fakultetit dhe departamentit sesa të PS.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në (Shtojcën 2.5) jepen informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, si dhe një pasqyrim i hollësishëm përsa i takon përmbajtjes së praktikave, seminareve apo orëve dhe temave të orëve praktike, si dhe literaturat përkatëse. Po ashtu jepen të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM 41 (i ndryshuar) si dhe syllabuset e detajuara për secilën lëndë.
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të	Sipas intervistave me personelin akademik të Departamentit të Agroushqimit, përmbajtja e programit rishihet për vit. Nga dokumentat në dispozicion u vërejt se përgjithësisht nuk ka patur ndonjë

vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>rishikim të programit por vetëm ndërrime të kategorizimit të moduleve, si edhe ndryshme të nivelit të krediteve të disa lëndëve. (Shtojca 2.12) Ndryshimet eventuale janë të këtij tipi:</p> <p>1. Lënda: "Administrimi i karrierës dhe aftësi në sipërmarrje" ndryshon nga tipi i veprimtarisë C në D; nga semestri I në semestrin e II; orët mësimore shtohen nga 30:15 në 39:13.</p> <p>Një nga ndërrimet që e mendojmë jo funksionale është zvogëlimi i krediteve të tezës/provimit të diplomës si më poshtë:</p> <p>2. Tezë diplome/provim diplome ndryshon nga 12 në 9 kredite.</p> <p>Ky zvogëlim nuk është i justifikuar, se pse ka ndodhur.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e PS MP CSU është e strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Modulet dhe praktikat mësimore janë të shpërndara në dy semestra. Ato mundësojnë marrjen e njohurive më të thelluara dhe profesionale në fushën e teknologjive të ndryshme ushqimore, cilësisë dhe sigurisë së ushqimeve. Sa më sipër theksohet që janë në përshtatje me kërkesat e tregut e punës dhe punësimin. E organizuar në nivel departamenti dhe fakulteti, parashikohet që përmbajtja e programit të rishihet çdo vit dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Nga GVJ konstatohet se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike për t'u përballur më lehtë me tregun e punës pas diplomimit të tyre.</p> <p>Nga dokumentacioni rezulton që kurrikula e programit "Cilësia dhe siguria ushqimore" (Shtojca 2.7) përmban mjaftueshëm module karakterizuese me qëllim formimin e kompetencave të përgjithshme, si edhe rritje dhe thellimin e njohurive të specialiteteve si teknologjia ushqimore, monitorimi dhe kontrolli i ushqimit, siguria ushqimore, analiza e rreziqeve, legjislacioni i sigurisë ushqimore dhe njohuri për çertifikimin, ruajtjen e produkteve, etj. Sa më sipër garanton që studentëve t'ju ofrohet mundësia për të krijuar një profil profesional dhe kompetenca të lidhura drejtpërdrejt me kërkesat e tregut të punës.</p>
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë	Për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit, lëndët dhe modulet janë të shpërndara në 2 semestra në mënyrë të ekuilibruar dhe sipas kërkesave ligjore. Është bërë kujdes në balancimin e orëve teorike

<p>mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>dhe praktike dhe lëndët e formimit profesional janë plotësuar me praktikë profesionale. Nga dokumentacioni në dispozicion dhe nga RVB vërehet që kurrikula e programit të studimit “Cilësia dhe siguria ushqimore” është hartuar në përputhje me nevojat e specialiteteve dhe e përafëruar me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre si dhe detaje të tjera janë përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit (Shtojca 2.5), modulet janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar midis veprimtarive formuese, me një raport që përputhet me atë të Shtojcës 1 të VKM 41 (i ndryshuar) dt. 24.1.2018. Po ashtu edhe shpërndarja e moduleve që bëjnë pjesë në fushën e sigurisë me atë të cilësisë së ushqimeve.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se të gjitha lëndët janë në përputhje me profilin e programit, dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga infrastruktura, kapacitetet e laboratoreve, bisedat me stafin etj, rezulton qartë se raporti teori/praktikë është mëse i kënaqshëm për finalizimin me sukses të programit, sa më sipër duhet të reflektohet më mirë në dokumentacion. Megjithatë ne kemi vërejtur që kapacitetet laboratorike janë në lartësinë e tyre por pjesëmarrja e studentëve në to nuk është në lartësinë e duhur.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion vihet re që raportet midis formimit teorik dhe praktik të materializuara sidomos në disa module të karakterit profesional synojnë të mundësojnë arritjen e objektivave formues. Informacionet në këto module janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional në fushën e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore.</p> <p>Në lidhje me transferime të studimeve teorikisht përmendet që ofrohet si mundësi por nuk evidentohen raste të tilla.</p> <p>Studentët e intervistuar pohojnë suporte në lidhje me internship dhe punësime në përfundim të studimeve. Nga dokumentacioni në dispozicion dhe RVB shihet që në kurrikul janë parashikuar në masën 31% nëndisiplina të ngjashme ose/dhe integruese që lidhen me disiplinat karakterizuese në mënyrë që të aftësohen studentët për të qenë fleksibël dhe gjithpërfshirës në sektore të ngjashme ushqimore. Këtu përfshihen module si: Toksikologjia ushqimore, Çertifikimi i produkteve ushqimore, Vlerësimi i produkteve me origjinë shtazore etj. (Shtojca 2.5; Shtojca 2.7).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB dhe takimeve me stafin e departamentit rezulton se; gjatë këtyre viteve është konstatuar një përpjekje intensive dhe e vazhdueshme e stafit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë shprehje e kompetenca që ju duhen për të ardhmen. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5-10 viteve të fundit (Shtojca 2.5). Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar që literatura ka nevojë për rifreskim si dhe evidentime më të sakta të saj (vitet referente) në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Kjo vihet re në disa lëndë dhe ju theksua GVB si dhe stafit</p>

	akademik gjatë takimeve.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Duke ju referuar DVV, është e qartë se ky program studimi ka një përmbajtje të tillë të lëndëve/moduleve që garanton formimin e specialistëve me aftësi dhe kompetenca të kënaqshme për nivelin e studimit Master Profesional Cilësia dhe Siguria Ushqimore.			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Nga studimi i dosjeve të programeve shihet që ato synojnë t'u ofrojnë studentëve kurrikula, metodologji, relativisht edhe literaturë dhe infrastrukturë të tillë që të jenë konkurrues në tregun e punës dhe të mund të ndjekin programet progresive të studimit në çdo universitet brenda e jashtë vendit. Programet synojnë rritjen e kompetencave kryesisht profesionale të studentëve, formimin e etikës, njohjen e legjislacionit dhe përfitim e shprehive teorike dhe praktike për të qenë të aftë në kryerjen e detyrave të ndryshme në fushën e teknologjisë ushqimore dhe jo vetëm.			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga RVB dhe biseda me GVB për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit departamenti i Agroushqimit ka lidhur marrëveshje dhe bërë konsultime me strukturat e arsimit në lidhje me kurrikulat e reja të cilat janë pasqyruar në programin e studimeve. Sipas (Shtojcës 2.10), marrëveshjet e lidhura nga institucioni janë ndihmesë për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i PS për departamentin në fjalë kanë problemin se nuk përmbushin plotësisht kërkesat e kualifikimit për mësim dhënie në nivelin Master: nga 13 personel akademik që japin mësim në programin e studimit gjatë 2020 - 2021 konstatojmë që janë 4 janë me nivel kualifikimi Master, 1 me titullin akademik profesor personel i ftuar (PAK). 3 janë me titullin Prof.As.Dr. (PAE) dhe 5 me gradën doktor i shkencave nga të cilët 9 (PAE) dhe 1 (PAK).			
	2019-2020		2020-2021	
Stafi akademik që angazhohet ne programin e studimit	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr		1		1
Prof.As.Dr	4		3	
Dr	5	1	4	1
Dr ne process				
Msc	3		3	1

	<table border="1" style="margin: auto;"> <tr> <td>Total</td> <td>12</td> <td>2</td> <td>10</td> <td>3</td> </tr> </table>	Total	12	2	10	3
Total	12	2	10	3		
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Gjithashtu nga GVB, dokumentat në dispozicion, intervistat me personelin akademik me kohë të plotë, gjykojmë se; kualifikimi i personelit plotëson nevojat për realizimin e programit të studimit si dhe ofron përvojën e nevojshme për përgatitjen nga ana profesionale të studentëve. Shkollimi dhe profili i studimeve të pedagogëve është gjithpërfshirës për të mundësuar realizimin sa me të mirë të të gjitha moduleve të programit të studimit (Shtojca 2.9).					
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Referuar jetëshkrimeve të personelit akademik dhe lëndëve që ata mbulojnë në këtë program studimi GVJ konstaton se fusha ekspertizës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet me lëndët që ata mbulojnë. Titujt akademikë janë si vijon; Personel akademik me kohë të plotë 3 janë me titullin akademik Prof.As.Dr., 2 janë me gradën Dr dhe 3 në nivelin master. Pjesa tjetër janë personel akademik me kohë të pjesshme kualifikimet e të cilëve janë si më poshtë: Prof.dr. janë 4, Dr. janë 2 dhe 5 janë niveli Master. Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitës në vend rezulton se, një pjesë e këtij stafi ka patur përvoja pune në agjenci shtetërore që lidhen me fushën e kontrollit të sigurisë ushqimore. Kjo i mundëson të transferojnë sa më mirë njohuritë dhe konceptet tek studentët dhe t'i përshtasin metodat e mësimdhënies në funksion të programit të studimit CSU.					
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UNIKO ka disa marrëveshje bashkëpunimi që duket të jenë shumë ndihmuese për praktikat profesionale, temat e diplomave (megjithëse të kufizuara) si dhe orë të tjera praktike. Konkretisht marrëveshjet janë me: Drejtorinë Rajonale të Arsimit, Drejtorinë e Ujësjetës Kanalizimeve Korçë; Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Korçë, Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Korçë që përbëhen nga personel me kualifikim profesional të lartë, por edhe subjekte private që kanë shkallë të lartë ekspertize profesionale dhe që garantojnë ndjekjen e studentëve gjatë praktikave. Po në funksion të formimit profesional të studentëve janë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me fabrikën "Birra Korça", etj. siç është referuar në përmbushjen e Standardit I.5 (Shtojca 2.10).					
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e	Personeli ndihmës akademik i angazhuar është i specializuar në fushën përkatëse dhe me përvojë. Angazhimi i tij në procesin mësimor, veçanërisht në seminare, praktika dhe temat e masterit, është bërë i detyrueshëm me urdhrin e Rektorit të UNIKO për rolin e personelit ndihmësakademik.					

mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>Programi i studimit “CSU” megjithëse është një program relativisht i ri ai tenton të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Departamenti rishikon kurrikulat duke përfshirë edhe mendimin e studentëve në ndryshimet e tyre, sa më sipër evidentohen në planin mësimor. (Shtojca 2.7 dhe 2.12)</p> <p>Në grupet e vlerësimit të performancës mesimore marrin pjesë edhe studentët për të shprehur sugjerimet e tyre në lidhje me përmirësimin e pikave të dobta të këtyre programeve.</p> <p>Departamenti krahas studentëve ekzistues angazhon edhe studentët që kanë përfunduar studimet dhe punojnë në fushën e mësipërme nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumnit. (Shtojca 3.12) (Shtojca 3.20).</p>
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	<p>Nevoja për përmirësime të vazhdueshme të programit të studimit ka bërë që Departamenti i Agroushqimit të inkurajojë studentët që të përfshihen në diskutime për të dhënë propozimet e tyre për këtë qëllim. Kjo e diskutuar në parim nga personeli akademik dhe studentët gjatë intervistave.</p> <p>Në realitet ky vit në të cilin kontaktet me studentët kanë qenë virtuale nuk ka patur ndonjë reflektim konkret në këtë drejtim. Përgjatë bën fakti që studentët kërkojnë që për një realizim më të mirë dhe përmirësim të programit të studimit orët e mësimave praktike dhe puna në laboratore mbetet kërkesë e vazhdueshme e tyre.</p>
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar duke vlerësuar mendimet e tyre dhe duke marrë informacione dhe reagimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit. (Shtojca 3.12) (Shtojca 3.20). Ajo bën të ditur dhe shkëmben informacionet për ofertat për punësimin e studentëve, si edhe orientimin e të diplomuarve për punësime të mundshme. Pohohet nga intervistimi megjithëse me shumë vështirësi, tenton të mbajë kontakte me ta (deri në pesë vjet).</p>
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat	<p>UNIKO ka shumë marrëveshje me institucione publike e private po kështu edhe njësi të pushtetit vendor. Departamenti i Agroushqimit në bashkëpunim me këto institucione përditëson kurrikulat mësimore për të qënë sa më në funksion të nevojave specifike lokale në drejtimin e kontrollit dhe sigurisë</p>

dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	ushqimore, si edhe të rritjes së kualifikimit të studentëve në funksion të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga vizita monitoruese dhe nga dokumentacioni në dipozicon u konstatua se Fakulteti i Bujqësisë ka një infrastrukturë të kënaqshme për mësimdhënie si edhe për praktika mësimore dhe profesionale. Personeli akademik përdor metoda inovative të mësimdhënies në sipas drejtimit të studimeve, lëndëve/moduleve. Zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në UNIKO është cituar në Statut (Shtojca 1.1), në Rregulloren e veprimtarisë mësimore-kërkimore (Kreun VII; Shtojca 1.2) në Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies (Shtojca 3.24), si dhe Rregulloren e Programit (Shtojca 2.5), etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Dokumentacioni në dispozicion dhe intervistat e personelit akademik të departamentit dhe të programit të studimit vërtetoi se; Departamenti është struktura bazë që monitoron dhe vlerëson aftësitë mësimdhënëse dhe inovative. Monitorimi i aftësive mësimdhënëse të stafit akademik bëhet nëpërmjet strukturave të përherëshme dhe kontrolleve periodike. Gjithashtu Universiteti ka një zëvendës rektor për mësimdhënien, i cili organizon aktivitete të ndryshme mbi metodat e reja të mësimdhënies. Edhe projektet ndërkombëtare kanë ndihmuar në futjen e metodave të reja të mësimdhënies. Në fund të çdo semestri zhvillohet një pyetësor për tërheqjen periodike të opinionëve të studentëve me anë të një pyetësoi tip (Statuti i UNIKO dhe anketa me studentët) (Shtojca 1.1, 3.13). Nga takimi me personelin akademik pohohet se në FB, DA dhe nga përfaqësues të Rektoratit organizohen kontrolle për zbatimin e çdo programi

	mësimor. Për gjithë stafin e brendshëm dhe të jashtëm ka një Dosje e disiplinuar nga një Udhëzim i posaçëm, që përmban informacion pranë zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pranë Departamentit, e cila ripërtërihet çdo vit (me Jetshkrimin, Syllabuset, Materialet Didaktike, etj.)			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në RVB pohohet se studentëve u është garantuar e drejta e pjesëmarrjes në të gjitha hallkat e hartimit të kurrikulave, në vlerësimin e brendshëm të institucionit, si edhe përfaqësimi i tyre në Senatën Akademik (Shtojca 1.11), sipas përcaktimit të rregullores së zgjedhjeve (Shtojca 1.19). se në përfundim të çdo semestri si rregull bëhen anketime me studentët lidhur me aftësitë në mësimdhënie dhe performancën e stafit (Shtojca 3.14), të cilat bëhen publike. Gjithashtu, nga intervistat me studentët dhe personelin akademik, pohohet që studentët janë shumë aktivë gjatë procesit të organizimit të pyetësorëve, dhe të gjitha sugjerimet dhe ankesat e tyre merren në konsideratë në takimin e radhës të analizës mësimore të realizuar nga departamenti në çdo fillim viti të ri akademik (Shtojca 3.8).			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në RVB pohohet se rezultatet e monitorimit të janë pjesë e Raporteve vjetore të UNIKO, të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilët gjenden në Dosjen ASCAL. Por GVJ nuk është i qartë nëse ato bëhen publike dhe në çfarë mënyre.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni në dispozicion nuk del në pah se në ç'mënyrë institucioni promovon shembujt më të mirë. Aty jepen shembuj të trajnimit të personelit akademik edhe duke përmendur programin TEMPUS megjithëse ai është mbyllur para se të hapej ky program studimi. Sygjerohet gjetjen e mekanizmave të vlerësimit dhe implementimin institucional të tyre me përkatësitë e specifikuar në Shtojcën 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			√	

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien, si edhe takimit me stafin akademik të këtij program studimi, u diskutua se përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies përbën një ndër prioritetet kryesore të departamentit. GVJ konstaton se në këtë program studimi praktikohen elementë të shumtë të veprimtarisë mësimore; të gjitha lëndët e modulet përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, praktika mësimore, detyra dhe projekte kursi, praktika profesionale, etj. U theksua që viti i fundit për shkak të pandemisë e ka kthyer formën e mësimdhënies në

	virtuale dhe ka kufizuar dhe minimizuar orët praktike dhe laboratorike. Edhe gjatë intervistave me studentët dëshmohej qartë që janë të informuar që në fillim të semestrit; gjatë zhvillimit të lëndës aplikohen praktikisht forma të larmishme të transmetimit të dijeve; leksionet, seminarët, detyra kursit, praktikat profesionale, orët e hapura. (<i>Shtojca 3.18 Shembull i orëve të hapura</i>).
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Nga takimet me personelin akademik evidentohet përfshirja e një numri të konsiderueshëm të lëndëve e moduleve në planin mësimor (<i>Shtojca 2.7</i>), kjo tregon diversitetin e formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies; të gjitha lëndët e modulet përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, praktika mësimore, laboratorë, detyra dhe projekte kursi, praktika profesionale, etj. Personeli akademik përshtatet dhe i përgjigjet plotësisht nevojave të studentëve, bazuar në prurjet periodike të çdo viti dhe prirjet individuale të tyre.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Gjatë vizitës në mjediset e institucionit rezultoi se infrastruktura dhe baza materiale në auditore dhe laboratore, në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve, lejon dhe mundëson aplikimin efektiv të metodave të shumëllojshme të mësimdhënies. Mjediset e institucionit kanë <i>Wi-Fi</i> ; sallat e leksioneve seminareve janë të përshtatshme, të pajisura me videoprojektor, tabela për të shkruar, postera informues, kanë sistem ngrohje, etj.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka jetëshkrim që plotëson kriteret dhe kompetencat në shpjegimin e njohurive dhe të koncepteve kjo pasqyrohet edhe në Raportet e Analizës së Punës Vjetore, Raportin e Performancës së stafi akademik, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët. Pra, në parim kërkesa e këtij Kriteri përmbushet. Por ne si GVJ kemi vërejtur një disakordancë të ngarkesës mësimore dhe shumë module të mbuluara nga një person i vetëm megjithëse me kualifikim "Nivel Master" .
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga intervistat e kryera rezultoi se bashkëpunimi pedagog student përta i përket informimit mbi lëndën, udhëzimin mbi detyrat e pavarura, apo aspekteve të tjera në dobi të përmirësimit të procesit të mësimdhënies është i realizuar. Konstatohet se studentët në mënyrë periodike plotësojnë pyetësorët e vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies (<i>Shtojca 3.13, Pyetësori studentor.pdf</i>) dhe (<i>Shtojca 3.14 Pyetësori i stafit akademik.pdf</i>). Fakti që studentët janë vetëm një vit akademik bën që kërkesat e tyre dhe mangësitë e vërejtura të reflektuara në pyetësorët në fjalë të mos të reflektohen Brenda kohës që ata janë duke ndjekur këtë master.
Kriteri 6. Personeli akademik	Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët rezultoi se; Metodat

përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	interaktive dhe diskutimi për ta bërë mësimin më tërheqës është pjesë interesante e diskutimeve me studentët. Ata pretendojnë se kanë atraksion kur mësimit shoqërohen me demonstrime, video, power point, animime të analizave kimike dhe biologjike, proceseve teknologjike, dhe sidomos me laboratore konkrete. Studentët reflektojnë se orët e mësimit janë tërheqëse sidomos ato që lidhen me tema praktike dhe me tematika konkrete.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me studentët dhe sqarimet e GVB rezultojnë që: për të stimuluar punën e pavarur të studentëve dhe për të rritur nivelin e mësimit prej tyre, në mënyrë graduale rritet pesha e detyrave dhe projekteve të kursit. Studentët shprehin që puna për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit zë një kohë relativisht të gjatë, kërkohet edhe një angazhim i madh i tyre jashtë orarit mësuesor. Studentët vlerësojnë punën në grup dhe sidomos edhe me pjesëmarrjen apo ndihmën e pedagogëve. Detyrat e kursit përgjithësisht mbetet një punë e pavarur dhe tërheqëse për studentët dhe rrit besimin e dyanshëm pedagog - student, krijon marrëdhënie profesionale midis tyre.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësimit dhe aftësinë profesionale, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësuesor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësuesor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në ASCAL si edhe vizita në Institucion u konstatua që procesi mësuesor në auditor, edhe punët laboratorike dhe seminarët të lidhura me PS MP CSU zhvillohet në hapësira të mjaftueshme, cilësore, të pastra, dhe të mirëmbajtura. (Shtojcat 1.15, 4.7). Auditorët shërbejnë si ambjente për realizimin e orëve të leksioneve dhe seminareve. Të gjithë auditorët janë të pajisur me videoprojektorë dhe me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësuesor (banka, karrige, tabela, lapustila), (Shtojca 4.3). Hapësira 2766 m ² përfshin; salla leksionesh, seminaresh, laboratorë, biblioteka etj., të cilat janë në dispozicion për rreth 700 studentë të FB. Sipas RVB Sipërfaqja në dispozicion e zhvillimit të programit mësuesor për Departamentin e Agronomisë përllëgohet në 2.54 m ² /student.
Kriteri 2. Mjediset e dedikuara për procesin mësuesor janë funksionale dhe të pajisura me logjistike e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësuesor dhe praktikave.	Sipërfaqet e këtyre mjediseve janë të mjaftueshme dhe të pajisura me elementët logjistike të nevojshëm për realizimin normal të procesit mësuesor. Mjediset mësuesore përdoren posaçërisht për aktivitetin e mësimit. Materialet logjistike të nevojshme zëvendësohen ose riparohen sipas rastit.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe	Sipas RVB dhe nga takimet konstatuam se personeli akademik si edhe

Signature *Photo*

<p>studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>studentët, shfrytëzojnë infrastrukturën e FB, ku përfshihet edhe infrastruktura IT dhe Sistemi elektronik (ESSE3) (sipas Shtojcave: 1.5, 1.6, 1.6.1) i vlerësimit gjithëvjeter dhe përfundimtar të studentëve. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet informimi në kohë reale i studentëve lidhur me rezultatet e tyre. GVJ konstaton se sistemi i mësipërm nuk funksiononte për momentin për shkak të mbarimit të kontratës (afatit të pagesave). Po kështu edhe website i UNIKO.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB për të gjitha modulet e programit mësimor “Cilësia dhe siguria ushqimore” ekziston literaturë bazë në gjuhën shqipe. Kjo literaturë përfshin materiale të botuara apo dispenca të përgatitura. Në Syllabuse vihet re se literatura e përdorur në lëndë të ndryshme është përgjithësisht me tekste ose leksione të shkruara nga secili pedagog përgjegjës. GVJ rithekson përditësimin e literaturës në përdorim, recensimin e saj në mënyrë të rregull dhe të panashëm, përfshirë këtu edhe Leksionet e shkruara në përdorim, e shtjelluar më gjatë në Standardin II.3, Kriteri 4.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita monitoruese DAGU ka në dispozicion Bibliotekën e Fakultetit dhe atë të përgjithshme të UNIKO-s (Shtojca 4.2). Sipas RVB: Biblioteka e universitetit “Fan S. Noli” u krijua që në vitet e para të çeljes së Institutit të Lartë Bujqësor. Ajo ka në fondin e vet rreth 30.000 libra me mbi 12.000 tituj që u përkasin fushave të ndryshme, por më tepër të përqëndruara në ato të ekonomisë së tregut, agropërpunimit, agronomisë, psiko - pedagogjisë, revista, enciklopedi, fjalorë gjuhësorë ose terminologjikë. Ky fond është aktualisht i shpërndarë në pesë mjedise dhe përkatësisht në: Biblioteka Shkencore Universitare (Rektorat), Bibliotekën e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Bibliotekën e Fakultetit Ekonomik, Bibliotekën e Fakultetit të Bujqësisë, Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane (Shtojca 4.3). Në bibliotekën e fakultetit kanë akses studentë dhe pedagogë të pajisur me kartelat e tyre personale në këto biblioteka. Të gjithë studentët e interesuar përgjatë orarit zyrtar të punës. Tekstet synojnë të plotësojnë kërkesat e programit të lëndëve. Materialet profesionale të specialiteteve të agropërpunimit ju shërbejnë jo vetëm studentëve por edhe specialistëve të sektorit. Ato i janë nënshtruar procedurës së opionencave dhe miratimit në njësinë bazë për të qenë në përputhje me syllabusin e modulit. Krahas tekstit apo ciklit të leksioneve, çdo pedagog krijon prezantimet e leksioneve të tij në Power Point. Literatura e rekomanduar është kryesisht në gjuhën angleze. Nga intervistat me studentët ata parapëlqejnë materialet elektronike. Ky vit për ta nuk ka qenë aktiv në bibliotekat e mjediseve të Universitetit. Shprehen se leksionet dhe literatura në dispozicion i përmbush kërkesat e tyre për lëndën/modulin.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, takimeve dhe monitorimit për këtë kriter na rezultojnë: Personeli akademik përdor në funksion të mësimdhënies platformën on-line (e-learning) Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams (Shtojca 2.17). Ky është një sistem i brendshëm që nuk verifikohet nga ne pa kodet e hyrjes.</p> <p>Gjithashtu në RVB thuhet që; Sistemi i brendshëm i komunikimit (https://www.uniko.esse3.u-gov.rash.al/Home.do) (Shtojca 5.3) funksionon si hapësirë e nevojshme për ndërveprimin, këmbimin e informacioneve dhe</p>

	<p>aksesin në dokumentacion elektronik si të studentëve ashtu edhe pedagogëve. Çdo individ ka hapësirën e vet të dedikuar dhe informacioni i këmbyer mund të jetë privat ose ne grup. Për ti aksesuar individët janë të pajisur me adresa elektronike personale, institucionale. Në realitet ne nuk arritëm ta verifikojmë sa më sipër, pra ky system nuk është funksional për të gjithë UNIKO.</p> <p>Në RVB thuhet që: Prej datës 1 mars 2018, stafit mësimdhënës, studentëve të Universitetit “Fan S. Noli”, si dhe komunitetit të Korçës, u ofrohet një mundësi e re qasjeje në Bibliotekën Digjitale ProQuest. UNIKO bleu të drejtën e anëtarësimit në këtë Bibliotekë për periudhën 1 Mars 2018 deri më 28 Shkurt 2019, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur midis UNIKO dhe ProQuest. Shërbimi do të jetë aktiv për stafin në vendin e punës, për studentët dhe për komunitetin në mjediset e Bibliotekës Universitare. Në Bibliotekën Digjitale ProQuest, do të gjeni një literaturë bashkëkohore, e cila mbulon fushat parësore të kërkimit në Universitet, si në fushën e edukimit, bujqësisë, ekonomisë, shkencat filologjike, shkencat sociale, natyrore, mjekësore, etj. Kjo bibliotekë nuk më është aktive apo funksionale.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Departamenti që ofron programin e Studimit MP CSU në kuadër të Fakultetit zotëron një numër të konsiderueshëm pajisjesh të cilat shfrytëzohen nga stafi dhe studentët për të kryer analiza të shumëllojshme të karakterit fiziko-kimik, mikrobiologjik dhe biokimik (Shtojca 4.3). Labororet e departamentit funksionojnë gjithashtu për analiza më të thelluara qofshin ato punime mikrotezash apo edhe përgatitje materiale shkencore.</p> <p>Janë 9 laboratorë mësimorë dhe shkencorë (Shtojca 1.3.1), që i përkasin jo vetëm departamentit të Agroushqimit por janë në dispozicion sipas RVB dhe intervistave me personelin akademik. Përmendim labororët e Agrokimisë, Pedologjisë, Kimisë Analitike, Biologjisë dhe Biologjisë Molekulare, dhe Informatikës, Mbrojtjes së Bimëve, Pentarisë, Perimtarisë dhe Fitoteknisë.</p> <p>Labororet ekzistojnë por nuk pamë ndonjë punë konkrete të realizuar nga personeli i departamentit apo studentët.</p> <p>DAGU bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE) Shtojca 1.8 me sipërfaqe prej 19 ha, direkt nën varësi të UNIKO.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Format e mësimin online (e-learning) të përdorura si dhe të linkuara në websitin e fakultetit janë: Google Classroom, Google Meet, eduMEET, Moodle, etj.</p> <p>Platforma Moodle nuk është aktive.</p> <p>RVB si edhe Stafi IT pohon instalimi i platformës OFFICE 365 (Shtojca 3.16, Model mësimi online.pdf) mundëson realizimin e mësimin online. Studentët pohojnë që kanë ndjekur mësimin online por gjithashtu ata shprehën të pakënaqur nga zgjatja e tij për shkak të pandemisë. Kjo e lidhur me kufizimet në përdorim, ndjekja kryesisht nga celularët sepse mungojnë PC për përdorime të gjata, si edhe mungesa e interaktivitetit dhe orëve praktike.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për</p>	<p>Sipas RVB dhe nga takimet konstatuam se personeli akademik si edhe studentët, përfshirë edhe ata të që ndjekin Programin, shfrytëzojnë infrastrukturën infrastrukturën e IT dhe Sistemin elektronik (ESSE3) të</p>

akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	vlerësimi gjithëvjetor dhe përfundimtar të studentëve. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet informimi në kohë reale i studentëve lidhur me rezultatet e tyre. Kjo përvojë pretendohet të jetë fuqizuar dhe përsosur më tej nga gjithë periudha e pandemisë Covid që jemi të gjithë duke kaluar prej rreth 2 vitesh. Mangësitë e kësaj pike u përmendën më sipër, ato janë të lidhura me mungesën e web për momentin.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga takimet e GVJ me stafin akademik dhe studentët që kanë realizuar tema diplomash dhe nga RVB na rezultojnë; Në përfundim të programit të studimit Cilësia dhe siguria ushqimore, studentët kanë mundësinë të finalizojnë studimet e tyre me provim formimi ose duke punuar e paraqitur mikroteza shkencore. Provimi i formimit përfshin çështje/pyetje kryesisht nga lëndët me spektër profesional dhe përgjigjet paraqiten përballë një komisioni pedagogësh të departamentit. Përsa i përket tezave praktike me të cilat punojnë studentët, ato përfshihen në linjat studimore të pedagogëve udhëheqës apo në rast argumentimi të fortë shkencor mbi idetë e vetë studentëve (Shtojca 4.4). Pedagogët i drejtojnë studentët tek literatura e nevojshme, i mbështetin ata gjatë gjithë punës kërkimore-shkencore dhe i ndihmojnë në shkrimin e mikrotezës. Finalizimi i saj konsiston në paraqitjen e punës përballë një komisioni pedagogësh të departamentit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			√	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Nga takimet dhe dokumentacioni në dispozicion rezultoi që; UNIKO në nivel institucional ka struktura të organizuara në mënyrë që të promovojnë mësimdhënien si edhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Këto struktura të posaçme bëjnë të mundur dhe monitorojnë procesin mësimor. Në Fakultetin e Bujqësisë respektohen parimet e përgjithshme dhe kërkesat specifike të “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”. Në nivel institucioni funksionon “Sektori Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë” (SKSC) në varësi të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (Shtojca 1.5. Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (njsbc, qka).pdf). Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, me Sektorin përkatës, që menaxhon Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Këto struktura veprojnë mbi bazën e Manualit të Cilësisë 2020 (Shtojca 1.16), në të cilin janë përcaktuar të gjithë elementët e sigurimit të cilësisë dhe përbushjes së standardeve.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik	Nga dokumentacioni na rezultojnë: SKSC menaxhon veprimtarinë e Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Në nivel fakulteti, njëri nga zëvendës dekanët është përgjegjës për ecurinë e procesit mësimor dhe garantimin e cilësisë së tij. Vetë departamenti luan një rol të rëndësishëm për cilësinë e

dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	mësimdhënies dhe rritjen e vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë e programeve të studimit që ofron.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nga vizita në nivel institucional, rezultoi se cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme. Këto struktura mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Cilësia e mësimdhënies monitorohet nga autoritetet drejtuese. Vërejmë që cilësia e mësimdhënies nuk ka ndonjë system të caktuar vlerësimi, apo metodologji për përmirësimin e saj në rastet kur nuk rezulton në nivelet e kërkuara.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga intervistat dhe dokumentacioni në dispozicion shihet qartë se kualifikimi i stafit akademik është një nga prioritetet e departamentit. UNIKO nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime me qëllim zhvillimin dhe integrimin e aftësive të tyre. Personeli akademik i përfshirë rezulton të jetë i kualifikuar (Shtojca 4.1. Tabela e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit). Nga takimet me personelin akademik ata shprehen se bëjnë përpjekjet maksimale për tu kualifikuar dhe se për publikimet në revista prestigjioze ju nevojitet një nivel më i lartë pune dhe një mbështetje më e madhe institucionale. Ajo që do donim të theksonim jo vetëm në lidhje me kalifikimet por edhe më gjerë, do ishte fakti që si tek personeli ashtu edhe studentët, në rastin e këtij programi profesional studimi, të vihej theksi tek kalifikimet profesionale më shumë se tek ato shkencore. Duke u nisur nga fakti që UNIKO ka një spektër të gjerë të marrëveshjeve me biznese profesionale sygjerojmë që ato të mos mbeten vetëm në letër por t'i shërbejnë kualifikimeve dhe kategorizimeve të specialistëve të kësaj fushe.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Personeli akademik u shpreh se i kushton vëmendje të vazhdueshme përmirësimit të leksioneve dhe materialeve të tjera mësimore. Kjo për faktin që programi është relativisht i ri dhe duhet të përfshijë në leksione zhvillimet më të fundit, të cilat i shërbejnë këtij qëllimi.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik janë tërësisht përgjegjës dhe të angazhuar në programin e studimit. Vihet re një tendencë pozitive në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies si dhe implementimin e metodave të reja. Periudha e pandemisë ka kaluar mësimin online me metodat e cituara më sipër.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në	Në lidhje me testimin e metodave të reja ato shihen të lidhura me mësimdhënien online. Në RVB thuhet që: "Rezultatet e metodave të reja në mësimdhënie janë objekt i analizave vjetore të mësimdhënies, të cilat realizohen me pjesëmarrjen e stafit pedagogjik dhe atij ndihmësmësimor", por

mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	nuk cilësohet asnjë metodë e re mësimdhënie.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Ky kriter nuk u konstatua të jetë zbatuar nga raporti (RVB) por edhe nga takimet në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga intervistat me studentët rezulton se ata njoftohen që në momentin e parë që prezantohen me lëndën dhe pedagogët përgjegjës mbi ngarkesën javore dhe semestrale të saj, numrin e krediteve, shpërndarjen e të gjithë elementëve të programit të studimit dhe me mënyrën e vlerësimit të vazhduar (30%) dhe final (70%). Rregullorja e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore e Universitetit “Fan S. Noli” neni 82, 83 (Shtojca 1.2), në Rregulloren e organizimit të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore në FB (Shtojca 2.2), Rregulloren e brendshme të departamentit (Shtojca 2.3) dhe Rregulloren e vetë Programit. Titullarët e lëndëve i informojnë studentët në auditor ose përmes postës elektronike, ku dërgohen syllabuset ose materiale të tjera që mbështesin procesin mësimor.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët konfirmojnë se njoftohen në rastet kur lënda është e ndarë me module, të cilat mbulohen nga disa anëtarë të personelit akademik, si dhe në mënyrë të detajuar mbi metodologjinë e testimit, mënyrën e grumbullimit të pikëve brenda modulit, dhe shumën e pikëve të të gjitha moduleve deri në marrjen e vlerësimit final.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve siç u përmend më sipër ndahet në vlerësimin e vazhduar (deri në 30%) të totalit të pikëve dhe atë përfundimtar dhe realizohet në forma të shumëllojshme, përfshirë organizimin e seminareve, detyrave të ndërmjetme, ushtrimeve dhe punëve laboratorike, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, etj. Provimi përfundimtar zë deri në 70% të totalit të pikëve dhe

dhe kompetencat e fituara.	realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe gojë cilësuar në çdo syllabus moduli.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Sipas (Shtojca 2.5, Rregullorja e Programit të Studimit 2020-2021); vlerësimi i studentëve ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit si seminare, detyra kursi, teste paraprake etj. (30%), si dhe vlerësimi përfundimtar (70%) të pikëve i takojnë provimit final.</p> <p>Po sipas “Rregullores së Programit të Studimit”, raportet mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/ët në programin e modulit dhe ju bëhet e ditur studentëve me fillimin e modulit mësimor.</p> <p>Vlerësimi i vazhduar merr parasysh frekuentimin, angazhimin në laboratore, ushtrime, seminare, vlerësime të detyrave, projekturseve etj. Provimi mund të realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Minimumi për të qenë kalues është mbi 40% të gjithë pikëve.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Në RVB thuhet që: UNIKO përdor një sistem të mirëfillt elektronik ‘ESSE3’ (Shtojca 1.6) në bazë të marrëveshjes me RASH (Shtojca 1.6.1) për pasqyrimin dhe transparencën e vlerësimit jo vetëm për studentët dhe institucionin por edhe për palë të treta (Shtojca 5.3). Pikët e vlerësimit gjatë vitit akademik hidhen në sistemin ESSE3 dhe historiku i tyre ruhet nga sistemi për tu konsideruar nga pedagogu edhe për sezonet e tjera kur studenti është ngelës në sezonin normal të modulit. Hyrjet në sistem janë vetëm në periudhën e sezoneve, të rakorduara midis pedagogut, sekretarisë mësimore dhe menaxhimit të sistemit, duke shmangur abuzimet e mundshme”. Nga takimet konstatojmë se në UNIKO (momentalisht) nuk e ka aktiv sistemin elektronik i testimit dhe vlerësimit të studentëve.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Nga RVB dhe nga intervistat me stafin e departamentit rezultoi që: në rastin e provimeve përfundimtare të secilës lëndë departamenti ngrre komisione me të paktën 2 pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës; për Provimin e diplomës komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Komisionet miratohen nga Dekani, përpara publikimit të datave të provimeve dhe të diplomës. Vlerësimi final i studentit llogaritet nga mesatarja e thjeshtë arithmetike e vlerësimeve të secilit pedagog anëtar i komisionit dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët.</p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të	Testimi i vlerësimit të dijeve kur ai zhvillohet vetëm me shkrim bëhet në

njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	mënyrë anonime me kodifikim. Kjo nuk realizohet në rastet kur provimi është me shkrim dhe me gojë si dhe në rastet kur provimi bëhet vetëm me gojë. Titullari i lëndës është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, studentët kanë të drejtë të shikojnë tezën e provimit në prani të titullarit të lëndës, për sqarimet e duhura. Pasi pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, printohet proces-verbali nga sistemi, firmoset nga titullari dhe dorëzohet në Sekretarinë Mësimore.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët pohojnë se gjatë vlerësimit të vazhduar (30%), por dhe gjatë vlerësimit përfundimtar (me shkrim dhe me gojë) personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme bën sqarime të qarta në mënyrë që edhe vetë studenti të ndërgjegjësohet mbi arritjet momentale dhe të mund të përmirësohet në të ardhmen.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Sa më sipër GVJ vëren që personeli akademik ka krijuar një sistem pune me studentët në mënyrë të tillë që të shmangen plagjiaturat gjatë detyrave të kursit duke i motivuar me ide të reja si dhe punë praktike të ndryshme. Po kështu kopjimi në provime ju bëhet e qartë që është i patolerueshëm nga personeli akademik. Departamenti zbaton rregullat dhe marrin masa për shmangien e mashtrimit akademik. Studentëve u është bërë e qartë se ata kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës të UNIKO, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas dokumentacionit dhe monitorimin në universitet, rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 6 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti njihet me vlerësimin e tij nëpërmjet llogarisë së tij me mail. Fillimisht listohen pikët e vitit dhe më pas sipas rregullores, llojit të testimit të dijeve merr pikët e provimit përfundimtar si dhe notën korresponduese sipas tyre. Rregullorja e programit të studimit sqaron detajet. Studentët shprehen të njohur dhe kënaqur me sistemin e vlerësimit. Pasi pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, printohet proces-verbali nga sistemi, firmoset nga titullari dhe dorëzohet në Sekretarinë mësimore.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas bisedave me studentët, si dhe stafin akademik për pjesën e Rregullores së programit të studimit për pjesën e lidhur me kërkesat dhe ankimimin rezultoi që studentët kanë të drejtë të ankohet në rast se ndaj tyre janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar. Në RVB dhe nga takimet nuk dokumentohet të ketë patur ankesa të tilla në Programin në shqyrtim. Sipas rregullores (<i>Shtojca 2.5</i>), ky vendim është i formës së prerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet plotësisht

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	
				√

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Sipas RVB ky program studimi është i mbështetur në rregulloren e hartimit të kurrikulave dhe mundëson formim bashkëkohor të studentëve. Programi ka të gërshetuara aftësimin praktik, metodat e reja të përpunimit, standartizimin dhe sigurimin e cilësisë të produkteve ushqimore për treg. Stuktura në mënyrë të tillë që të përfshijë disiplinë, metodologji dhe kulturë të përgjithshme, disiplinë me lëndë karakterizuese shkencore, nëndisiplina grupe lëndësh me zgjedhje, aftësi komunikuese, praktika profesionale dhe mikrotezë diplome. Një rëndësi të veçantë i jepet kërkimit të studentit nëpërmjet detyrave dhe projekteve të kursit (Shtojca 2.7, 2.8). Aftësitë e fituara, studentëve ju kërkohet t'i demonstrojnë më pas në përgatitjen dhe prezantimin e detyrave/projekteve të kursit që duhet ti mbrojnë në kuadër të zhvillimit të moduleve me karakter të mirëfilltë profesional.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Siç edhe pohohet nga RVB; Departamenti i Agroushqimit mbështet dhe promovon idetë dhe praktikave inovatore në industrinë ushqimore, duke inkurajuar implementimin e praktikave të mira në çdo sektor të prodhimit ushqimor bazuar edhe në analizën në përfundim të modulit që hartojnë pedagogët (Shtojca 3.17). Duke qënë sektori më dinamik i zhvillimit të industrisë ushqimore, Agroushqimi është njëkohësisht edhe sektori që angazhon vëmendjen më të madhe lidhur me implementimin. Nga monitorimi rezulton që, studentët demonstrojnë përgatitjen e tyre në prezantimin e detyrave të kursit, gjatë zhvillimit të moduleve me karakter profesional.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimet me personelin akademik dhe studentët si dhe nga (Shtojca 3.17. Model analiza në përfundim të një moduli), konstatohet se ecuria e procesit mësimor për secilën lëndë/modul shqyrtohet edhe gjatë diskutimeve dhe në analizat vjetore të punës në DAGU, FB, NJSBC, etj. Gjithashtu kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, mangësitë e vërejtjet, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo moduli/lënde nëpërmjet anketimit për çdo modul.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Nga monitorimi rezultoi se personeli akademik i Departamentit të Agroushqimit në përfundim të çdo lënde vë në pah çështjet më të rëndësishme. Pedagogët përgatisin grupin e pyetjeve orientuese për përgatitjen e lëndës për provim nga studenti. Kjo bëhet gjatë seminareve për grup leksionesh, ose kolokiumesh në disa lëndë të tjera. Konsultime para provimeve realizohen në disa lëndë. Të gjitha materialet pedagogu i depozitohen në dosjen e pedagogut (Shtojca 2.16).
Kriteri 5. Personeli akademik (i	Personeli akademik i Departamentit gjatë takimit pohon se ka qënë pjesë e

<p>brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>programeve “Erasmus+” (Shtojca 2.19. Mobilitete trajnime Erasmus +). Sa më sipër ata theksojnë faktin që kanë sjellë eksperiencat më të mira dhe tentojnë të përdorin teknika inovative që aplikohen në universitetet e Rajonit të Ballkanit dhe si edhe Evropës. Ata mendojnë se kjo ka qenë një bazë shumë e mirë në realizimin e leksioneve të hapura. Studentët, gjithashtu pohojnë realizimin dhe informimin e vazhdueshëm mbi përparimet e shkencës nëpërmjet seminareve apo leksioneve të hapura. (Shtojca 3.18. Shembull i orëve të hapura).</p> <p>Sipas GVB edhe personeli akademik i ri ka marrë pjesë në orë mësimore që zhvillojnë pedagogët më me përvojë, me qëllim që të përfitojnë dhe transferojnë përvojën e tyre, si dhe të sigurojnë garantimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Shtojca 2.9. Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në program) rezulton se personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi është i kualifikuar, gjë që rrit mundësinë e transmetimit të dijeve dhe përgatitjen e specialistëve me kompetenca të kënaqshme në këtë drejtim. Sa më sipër shihet edhe në: (Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR).</p> <p>Problemet e konstatuara janë të lidhura me pasqyrimin e orëve laboratorike në program si edhe përfshirjen e personelit akademik me kualifikim Master në mësimdhënien e PS MP CSU.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga intervistat me studentët ata dëshmojnë se personeli akademik ndihmon dhe i mbështet punën në grup, duke nxitur jo vetëm debatin, por dhe diskutimin e gjerë për dijet e marra. Sa më sipër shihet edhe në faktin që një pjesë e mirë e detyrave të kursit, nuk janë punë individuale e studentit, por janë të realizuar në grupe me disa studentë, ku secili mundohet të japë kontributin e tij. Gjithashtu praktikat profesionale kryhen nën kontrollin e pedagogut përgjegjës dhe drejtuesve të subjekteve të ndryshme të prodhimit. Në përfundim të praktikës profesionale studentët prezantojnë çfarë kanë parë dhe mësuar, si dhe çfarë ata propozojnë për të përmirësuar diçka, për situata të veçanta me të cilët ata janë ndeshur gjatë kohës së praktikës.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Në dokumentat në dispozicion vihet re që; UNIKO mbështet dhe promovon idetë dhe praktikat inovatore në sektorin e ushqimit dhe agropërpunimit, duke nxitur zbatimin e praktikave të mira. Sa më sipër trajtohen gjatë leksioneve, në tekstet mësimore dhe dispensave. Fakti që masteri në fjalë është profesional dhe jo shkencor vërehet që materialet shkencore për studime të avancuara kërkimore e shkencore në UNIKO janë të kufizuara. Për këtë, personeli akademik tenton të përfshijë studentët, në disa nga projektet që financohen nga donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit. Sa më sipër është një mundësi e mirë informative dhe profesionale në punën e tyre.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>UNIKO mbështet brenda mundësive të veta studimet e avancuara dhe kërkimet shkencore. Ndonëse fondet për studime të avancuara kërkimore dhe shkencore në UNIKO janë të kufizuara, stafi pedagogjik bën kujdes të përfshijë në projektet e kërkimit shkencor që financohen nga donator të ndryshëm dhe studentë. Angazhimi në projekte të tilla ju ka ofruar këtyre të fundit një mundësi të mirë për tu njohur me ide dhe praktika të reja, që do t’i</p>

	shërbejnë në të ardhmen e karrierës së tyre profesionale.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Grupi i vlerësimit konstaton se numri i mobiliteteve të studentëve është relativisht i vogël. UNIKO është partner në disa projekte ERASMUS+, të cilat kanë mundësuar që një numër i konsiderueshëm studentësh të ndjekin një pjesë të studimeve të tyre në Universitetet e tjera (Shtojca 2.10). Sa më sipër nuk është tipike për masterin profesional. Mund të themi se në këtë aspekt personeli akademik duhet të jetë më aktiv në aplikimin në projekte për të rritur mobilitetin e studentëve.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>Nga takimet me grupin e vlerësimit, personelin akademik dhe nga RVB, konstatohet se departamenti bashkëpunon me Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE) sipas (Shtojcës 4.9) dhe që është direkt nën varësi të UNIKO, me bazën e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), si edhe AKU në Korçë.</p> <p>Nga (Shtojca 2.10) del qartë se UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me Qarkun Korçë, Bashkitë e Korçës, Pogradecit, Devollit, Ersekës dhe Maliqit dhe me institucione të tjera shtetërore. Duke u mbështetur në këto marrëveshje studentët e programit kryejnë praktika mësimore dhe profesionale pranë tyre. Departamenti ka bashkëpunime edhe me një sërë biznesesh të tjera në fushën e prodhimit të kulturave të ndryshme bujqësore ku zhvillohen pjesa më e madhe e praktikave mësimore dhe profesionale.</p>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	<p>Sipas RVB, takimin me personelin akademik dhe studentët, theksohet që; Departamenti synon që nëpërmjet këtyre marrëveshjeve me ekonomi të ndryshme bujqësore të prodhimeve dhe produkteve ushqimore, të arrijnë të shkëmbejnë përvoja dhe eksperiencën në fusha përkatëse të studimit dhe kërkimit për çështje të përbashkëta.</p> <p>Personeli akademik synon të identifikojë dhe të zgjidhë probleme të cilat hasen në fushën e cilësisë ushqimore, agropërpunimit si dhe të rritjes së cilësisë së prodhimit ushqimor.</p>
Kriteri 3. Praktikën profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin	Lidhur me Praktikën Profesionale vërejmë se është e vetmja Lëndë Plotësuese (D) me gjithsej 2 Kredite (3%). Sipas VKM 41/2017 në Masterin Profesional Lëndët Plotësuese (D) duhet të kenë një vëllim prej 10% (6 kredite). Këshillojmë që Praktika Profesionale të shkojë në 6 Kredite, 150 orë ose 6 javë punë në subjektet e kontraktuara.

përkatës.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në RVB, në Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të FB, dhe atë të Programit është përcaktuar qartë procedura për dhënien e Provimit final ose Mbrojtjen e diplomës (Shtojca 3.11). Data e provimit dhe e mbrojtjes së mikrotezës publikohet në web dhe në faqen e njoftimeve në mjediset e fakultetit, provimi/mbrojtja është i/e hapur dhe familjarë dhe/ose studentë të programit të studimit ose jashtë tij janë të ftuar/lejuar të marrin pjesë (Shtojca 1.2, Neni 108). Sa më sipër u konfirmua nga studentët dhe personeli akademik gjatë intervistimeve.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Nga takimi me personelin akademik të Departamentit rezultoi që ata përcaktojnë listën e temave për diploma në bashkëpunim me studentët. Sa më sipër bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti (Shtojca 2.5). Gjithashtu personeli akademik dhe studentët pohuan se ata janë të pajisur udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës në rastet kur nuk zhvillohet temë por provim final. Përgjegjësi i departamentit, sekretaret e departamentit dhe personeli akademik asistojnë studentët gjatë periudhës së përgatitjes së provimit final dhe mbrojtjes së diplomës (Shtojca 2.14). Programi i provimit të formimit ndërtohet në përputhje me kurrikulat mësimore të programit të studimit. Sipas RVB dhe intervistave konfirmohet që; në funksion të provimit të formimit hartohet një program i veçantë, i cili bëhet publik shumë kohë përpara afatit të përcaktuar të provimit në faqen e internetit të Departamentit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në RVB nuk jepen detaje në lidhje me komisionin e administrimit të provimit final, në rastet kur zhvillohet i tillë dhe jo mbrojtje teze. Po kështu, studentët e intervistuar ishin të gjithë që kanë mbrojtur mikroteza ose nuk kanë arritur në këtë stad. Sipas RVB; Vlerësimi i studentëve bëhet me notë me sistemin e notës maksimale 10. Vlerësimi bëhet i hapur dhe i diskutueshëm me studentin nëse ka, para se ai të hidhet në procesverbal. Në rastin e diplomës një kolonë është me vërejtje nëse ka. Proces-verbali firmoset nga të gjithë pedagogët pjesëmarrës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Për diplomën studentit orientohet nga pedagogu udhëheqës për planin e punës dhe ndihmohet prej tij për kërkimin teorik, punën praktike, përpunimin e të dhënave etj. Në çdo hap studentit komunikon në mënyrë të vazhdueshme me udhëheqësin, duke ndjekur të gjitha hapat për punën dhe shkrimin e punimit duke zbatuar Udhëzuesin për punën e diplomës. Udhëheqësi garanton cilësinë

	e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.			
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në rastin e diplomimit me Punë diplome, studenti së bashku me pedagogun udhëheqës përcaktojnë planin e detajuar të punës, bazuar në fushën e studimit të përcaktuar, ku përfshihen, zona e studimit/objekti i studimit dhe baza materiale etj. Disa punë diplomash realizohen edhe me mbështetjen e institucioneve me të cilat DAGU ka marrëveshje.			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës ndihmon studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit me anë të nënshkrimit të mikrorezesës dhe asistimit gjatë paraqitjes së saj (Shtojca 4.4).			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi i studentëve bëhet me notë me sistemin e notës maksimale 10. Vlerësimi bëhet i hapur dhe i diskutueshëm me studentin nëse ka, para se ai të hidhet në procesverbal. Në rastin e diplomës një kolonë është me vërejtje nëse ka. Procesverbali firmoset nga të gjithë pedagogët pjesëmarrës.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sekretaria e Fakultetit të Bujqësisë, në përfundim të studimeve pajis studentin me diplome dhe suplementin e saj në shqip dhe anglisht të miratuara nga Ministria e Arsimit. Si një event shumë i rëndësishëm. Diploma i dorëzohet personalisht studentit, i cili duhet të firmosë në librin e protokolluar të diplomave. Duplikat nuk lëshohet (Shtojca 2.6).			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe intervistat e studentëve rezultoi se: Bashkë me diplomën dhe aneksin e saj, studentëve ju vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit Master Profesional "Cilësia dhe Siguria Ushqimore".			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Nga takimi në sekretarinë mësimore rezulton se Sekretaria mësimore e FB mban Regjistër themeltar, të arritjeve akademike, të lëshimit të diplomave të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së Programit të studimit, të dhëna mbi Diplomën ose diplomat e marra bashkë me Suplementin e diplomës etj. Sa më sipër janë në përputhje dhe të formatuara sipas kërkesave ligjore. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej Sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. Një kopje e punimeve të diplomave ruhen në fondin e Departamentit në mënyrë të përhershme. Nga takimi u vu re se ngarkesa e sekretarisë është e lartë, nuk ka të dokumentuar asnjë kontroll të brendshëm për vlerësimin e situatës në rastet e ndonjë gabimi eventual apo ankimeve të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			√	
--	--	--	---	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e punësimit të cilat bëhen publike (Shtojca 1.4; takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore). Përzgjedhja e kandidatëve bëhet me konkurs. Dosjet e aplikantëve për punë gjenden në Sektorin Juridik dhe Protokoll -Arkiv (RVB, f35)</p> <p>Procedura e zhvillimit të konkursit dhe përzgjedhjes së kandidatëve në Departamentin e Agroushqimit është transparente dhe në përputhje me bazën ligjore. (Shtojca 1.23). Ajo zhvillohet kur Departamenti i Agroushqimit ndjen nevojën për të prëmbushur nevojat e tij.</p> <p>Institucioni përcakton kriteret, si dhe një procedurë të qartë në rregulloren e brendshme për rekrutimin e stafit akademik (RVB, fq 35), si dhe synon rekrutimin e një stafi të kualifikuar (1.13; 4.1). Në Rregulloret përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të kategorive të ndryshme të personelit akademik (Shtojca 1.2 "Rregullore e organizimit të veprimatrisë mësimore dhe kërkimore shkencore e Universitetit "Fan Noli" Neni 32 Punësimi i personelit akademik).</p> <p>Dokumentacioni ruhet në Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore. Ndërsa njësia bazë ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që ka lidhje me aktivitetin akademik.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me</p>	

nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>UniKo siguron një mjedis të përshtatshëm për të gjithë personelin akademik, për kryerjen sa më të mirë të aktiviteteve akademike dhe shkencore (Vizita në ambjentet e Institucionit/ Departamentit).</p> <p>Stafi akademik mbështetet nga Institucioni për trainimin e tij të vazhduar. Institucioni ndjek një plan trainimi sipas prioriteteve (RVB, fq 36).</p>			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, përmes rrugëve të ndryshme. Stafi mbështetet financiarisht nga institucioni për publikimin e teksteve mësimore, sipas një udhëzimi të caktuar (Shtojca 1.12) apo pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat bëhen publike (Shtojca 5.1). Stafi akademik mund të përfitojë vitin sabbatik (Shtojca 1.22) sipas rregullave institucionale (Shtojcat 1.2; 1.1).</p> <p>Stafi akademik vlerësohet në mënyrë të vazhduar nga drejtuesit, por edhe nga studentët përmes pyetësorëve (Shtojca 3.13). Për GVJ nuk del e qartë se si reflektohen sugjerimet, komentet apo vërejtjet e studentëve. Në dispozicion të GVJ janë vendosur pyetësorët, por jo rezultatet e pyetësorëve dhe analiza e tyre.</p>			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 42


praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Agroushqimit, UniKO ka mjedise bashkekohore për zhvillimin e aktivitetit akademik, salla leksionesh, seminaresh, laboratorë, bibliotekë etj (RVB, faqe 37, Shtojca 4.3; vizita në IAL)</p> <p>Për zhvillimin e aktivitetit akademik krahas ambjenteve të vetë IAL, shfrytëzohen edhe hapësira që ofrohen nga institucione të tjera (Shtojca 1.15; 4.3; 3.5). Mund të përmendim këtu laboratorët institucional të sigurisë ushqimore, punishte të përpunimit të produkteve, fabrika, etj.</p> <p>Ambjentet janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Klasat janë të përshtatshme jo vetëm për grupe mësimore me numër të vogël studentësh, por edhe me një numër të madh. Departamenti shfrytëzon Laboratorë informatike, si dhe salla interneti sipas standarteve.</p> <p>Fakulteti disponon salla konferencash ku zhvillohen aktivitete edhe në rang universitetesh, të cilat janë të pajisura me kompjutera, videoprojektore, ekranë të mëdhenj, dërrasa të bardha, etj.</p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>				
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës, grupi i vlerësimit të jashtëm u informua dhe vizitoi bibliotekën e cila ishte e paisur me infrastrukturën e nevojshme (vënde për studim, internet, kompjutera etj), por edhe burimet e nevojshme të literaturës në mbështetje të studentëve dhe stafit akademik (Shtojca 4.2; 5.2). Ajo ka një fond prej 22 mijë libra e revista, ku rreth 3000 ofrohen në gjuhë të huaj. Aty përfshihet një fond i gjerë, si libra shkencorë, doktoratura, revista, bulteine etj. Institucioni u ka ofruar studentëve dhe stafit akademik përdorimin e Bibliotekës Digjitale ProQuest, e cila ofron burie bashkekohore. Periudha e blerjes tashmë ka skaduar, që në Shkurt të 2019 (RVB fq 38). GVJ sugjeron riaktivizimin e anëtarësimit në ProQuest ose në biblioteka të tjera digjitale.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është plotësisht e shfrytëzueshme nga studentët dhe stafi gjatë gjithë javës dhe në orare të zgjatura e të përshtatshme për tu shfrytëzuar nga studentët apo stafi. Pasurimi i bibliotekës bëhet duke u bazuar në kërkesat e paraqitura nga departamentet përpara miratimit të buxhetit, ose përmes dhurimeve. Për GVJ nuk del e qartë si është bërë pasurimi i bibliotekës, sa është fondi i librave, titujve që blihen çdo vit dhe cilët janë në funksion të programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Studentët janë të pajisur me kartë regjistrimi dhe biblioteka la një kartelë regjistrimi për çdo përdorues të bibliotekës (Shtojca 3.2).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Studentët orientohen për literaturën nga pedagogët e modulit, por edhe përmes syllabusit.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht dhe rekomandon anëtarësimin e institucionit në biblioteka digjitale, si dhe pasurim të rregullt të literaturës së bibliotekës në funksion të studentëve dhe stafit.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UniKo përdor sistemin ESSE3 të menaxhimit të informacionit në përputhje me rregulloren e universitetit (Shtojca 5.3). GVJ konstatoi gjatë vizitë në institucion, por edhe më pas, se ky sitem nuk ishte funksional. GVJ u informua se kjo është një situatë e përkohëshme. Në të gjitha ambjentet e UniKo ka internet në dispozicion të stafit dhe studentëve. UniKo ofron dhe studime në formën online (Shtojca 2.17).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni përgatit raporte vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare (Shtojca 2.19). GVB deklaron (RVB fq 40) se të gjitha të dhënat statistikore mbi numrin e studentëve, programet e studimit, ofertën akademike etj. bëhen publike në faqen e UniKo (GVB deklaron Shtojca 5.1, por ajo mungon në listen e evidencave) në përputhje me rregulloret e institucionit (Shtojca 3.11). Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se ky informacion mungon për shkak të problematikës të përmendur më sipër mbi faqen zyrtare të UniKo.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, pasi sistemi i menaxhimit të informacionit nuk është funksional. Programet e studimit të ofruara nga UniKo bëhen publike në faqen zyrtare të UniKo (RVB fq 36). Gjatë vizitës të realizuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, faqja nuk ishte e disponueshme. Grupi i vlerësimit të jashtëm u njoftua, se kjo ishte për arsye administrative. Pavarësisht shkaqeve, pasojat nuk janë të pakta, pasi ky fakt pengon bërjen publike të informacioneve, njoftimeve etj.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ konkludon se ky standart përmbushet kryesisht, pasi faqja zyrtare e UniKo nuk është e disponueshme për personat e interesuar, për rrjedhojë nuk mund të arrihen informacione të nevojshme, të përditësuara mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e institucionit.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Për këtë arsye GVJ rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për vënien në funksionim të faqes zyrtare të Institucionit dhe vënien në funksionim efikas të sistemit të menaxhimit të informacionit.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	

ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Burimet e financimit në UniKo janë: (i) buxheti i shtetit; (ii) të ardhurat nga paagesat e studentëve; (iii) të ardhura nga shërbimet e tjera; (iv) të ardhura të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; (v) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; (vi) veprimtari kërkimore shkencore. Të gjitha përdoren sipas një plan të përditësuar në mënyrë vjetore (Shtojcat 1.7; 1.8; 1.8.1).
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Institucioni përgatit bilance vjetore (Shtojca 3.15) të cilat pasqyrojnë gjendjen financiare, kapacitetet për situatën financiare, numrin e studentëve dhe gjenerimin e të ardhurave. Të ardhurat që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik, ndahet ndërmjet personelit akademik dhe UNIKO, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i administrimit (Shtojca 1.21). Njësia e auditimit të brendshëm realizon kontrollin dhe auditimin e brendshëm në përputhje me rregulloret (Shtojcat 1.7; 1.8; 1.8.1). UniKo në përputhje me ligjin i nënshtrohet dhe auditimi të jashtëm financiar nga KLSH dhe MASRI. Të gjitha rezultatet e auditimit i bëhen të njohura stafit akademik dhe administrativ.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose	

ndarjen e burimeve financiare.				
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			√	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Studentët mbështeten gjatë gjithë jetës së tyre studentore nga Institucioni dhe konkretisht nga Sektori i Kurikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, si dhe nga Koordinatorin e programit të studimit, të cilët i orientojnë studentët drejt tregut të punës, si dhe i ndjek ata dhe pas përfundimit të studimeve. RVB sqaron me detaje procedurat dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin kandidatët për pranimin në këtë program studimi.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të	GVJ u informua gjatë takimit me studentët se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë

studimit.	lehtësisht të kuptueshme (Takimi me studentët).			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni ofron mbështetje financiare për kategori të caktuara të studentëve, përmes bursave të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe sipas një procedure të përcaktuar qartë (Shtojcat 3.9; 5.1; 3.10). Institucioni mundëson mobilitetet e studentëve, në kuadër të programeve të ndryshme si Erasmus + (RVB, fq 43).			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni bën publike informacionin për programet e studimit në të gjithë elementët e tij (Shtojca 5.1), duke përfshirë dhe rregulloret e ndryshme (Shtojca 5.3). Këto dy evidenca të përmeldura në RVB mungojnë në listën e dokumentave mbështetës. Në rregulloret e Institucionit përshkruhen qartë rregullat dhe kërkesat e provimeve, informacione mbi mënyrat e vlerësimit, kriteret e pranimit, etj. (Shtojca 2.5).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Studentët informohen dhe për modalitetet e mbrojtjes së diplomës dhe procedurës së diplomimit (Shtojcat 1.2; 2.3). Institucioni organizon "Ditë të hapur" për informimin e maturantëve për programet e ndryshme të studimit (Shtojcat 3.10; 5.4; takimi me përfaqësues të
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e	

aftësive të studentëve në programin e studimit.	sektorit të kurikulës, vlerësimit institucional dhe Alumni).			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni ruan parimin e konfidencialitetit (takimi me studentët, takimi me përfaqësues të ndryshëm të zyrave mbështetëse).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Universiteti Fan Noli, Korçë garanton të drejtën e informimit të studentëve, i cili realizohet jo vetëm me anë të shkresave zyrtare, por edhe përmes rrugëve të tjera si telefonimit, e-mail, telekonferencave, etj., apo përmes faqes së IAL (RVB, fq. 44). Gjatë procesit të vlerësimit, kjo faqe nuk ishte e disponueshme, për arsyt e përmendura më sipër në këtë raport.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Për çdo student ekziston dosja personale e cila përditësohet në mënyrë të vazhduar. Departamenti i Agroushqimit i mbështet dhe orienton studentët për tregun e punës dhe mundësitë e punësimit (Shtojca 3.12). Sektori i kurikulës vlerësimi institucional dhe alumni organizon trajnime për mënyrat e aplikimit për punësim, për përgatitjen e CV, sjelljen gjatë intervistave të punës etj. Institucioni organizon aktivitete si panairi i punës, etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	IAL përdor sistemin ESSE 3, ku studentët përdorin adresat e personalizuara (në RVB sugjerohet Shtojca 5.1, por ajo nuk është e aktive). Përdorimi i adresave të personalizuara iu konfirmua GVJ gjatë vizitës në institucion më takimet me studentët (Takimi me studentët).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe	Midis stafit akademik dhe studentëve ka një komunikim të vazhduar, sipas orareve të paracaktuara.

organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.				
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Studentët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me sekretariatë mësimore duke filluar që nga momenti i regjistrimit (Shtojca 1.10, takimi me studentët). Institucioni siguron regjistrimin, ruajtjen e të dhënave, statistikat vjetore të të diplomuarve në përputhje me rregulloret e IAL (Shtojca 1.9) studenti pajiset me një adresë e-mail-i të zyrtarizuar (RVB fq. 46).												
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve sipas viteve akademike</th> <th>Student të regj për herë të parë</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>30</td> <td>5.75</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>27</td> <td>5.8</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>27</td> <td>6.49</td> </tr> </tbody> </table>	Numri i studentëve sipas viteve akademike	Student të regj për herë të parë	Nota mesatare	2018-2019	30	5.75	2019-2020	27	5.8	2020-2021	27	6.49
Numri i studentëve sipas viteve akademike	Student të regj për herë të parë	Nota mesatare											
2018-2019	30	5.75											
2019-2020	27	5.8											
2020-2021	27	6.49											
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Drejtorja e Kurikulave dhe Vlerësimit Institucional, Sektori i studimeve dhe TIK, si dhe sekretaria mësimore, Departamenti i Agroushqimit kontribuojnë në orientimin dhe këshillimin e studentëve (Shtojca 1.5).												
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e	Gjithashtu IAL realizon dhe garanton komunikimin e brendshëm i cili mund të jetë i formave të ndryshme, si verbal, virtual, përmes këndit të njoftimeve, etj. IAL disponon gjithashtu dhe statistika të punësimit (Shtojca 3.12).												

autorizuar.				
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Studentët përfaqësohen në këshillat studentore (Shtojca 1.17, takimi me studentët).</p> <p>Studentët kanë të drejtë të përdorin dhe shfrytëzojnë bibliotekën e IAL, përmes ID personale.</p> <p>Studentët vendosin komunikim me stafin akademik, marrin pjesë në trajnime, projekte, si dhe vlerësojnë procesin mësimor, si dhe cilësinë e mësimdhënies, dhe stafin akademik. Ata përfshihen në vendimmarrje, në përputhje me rregulloret e IAL apo Departamenteve (Shtojca 1.1, 2.2).</p> <p>Studentët mbështeten në mënyrë të vazhduar nga sekretaritet mësimore (RVJ fq 47, takimi me studentët).</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se studentët kanë të drejtë të japin mendimet e tyre dhe të bëjnë propozime mbi planet mësimore, etj. të cilat merren në konsideratë nga Departamenti i Agroushqimit (Takimi me studentët).</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Studentëve u garantohet mundësia e ankimimit të rezultateve, rishikimit dhe rivlerësimit nga ana e pedagogëve (Shtojca 1.2).</p>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të	

<p>Iartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>				
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>IAL informon studentët me rrugë dhe mënyra të ndryshme, si përmes broshurave (Shtojca 3.11).</p> <p>Sektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni si dhe Koordinator i Programit të Studimit janë në mbështetje të vazhduar të studentëve, duke i orientuar dhe këshilluar studentët përgjatë ciklit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Qendra e Karrierës orienton studentët drejt tregut të punës dhe ndihmon në integrimin e tyre në tregun e punës.</p> <p>UniKo organizon trainime për studentët për mënyrën e aplikimit për punësim, përgatitjen e një CV, sjelljen gjatë një interviste pune etj.</p> <p>IAL ka disa të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve (Shtojca 3.12).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe</p>	

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Pranimi i studentëve në programin e studimit Master Profesional: "CSU" bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara. Ngarkesa e pedagogëve të DAGU realizohet në përputhje aktet ligjore dhe nënligjore, rregulloret e institucionit, si dhe sipas kategorive të stafit akademik të përfshirë në procesin mësimor (Shtojca 4.5) dhe orët shtesë të stafit akademik mbulohen financiarisht nga burimet e brendshme të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	IAL vlerëson veprimtarinë mësimore përmes raporteve vjetore të cilat i drejtohen NJSBC (Shtojcat 3.4, 3.7). GVJ nuk u njoh me një raport konkret të analizës vjetore të programit të studimit. Aktiviteti akademik i DAGU realizohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL. Programet e studimit vlerësohen në mënyrë periodike, vjetore. NJSBC harton raporte vjetore ku merren në konsideratë sondazhet e studentëve, mbi programet e studimit, mbi mënyrën e mësimdhënies, apo inervistave, etj. (RVB, fq 49).
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i	GVJ nuk u njoh me raporte të cilat analizojnë gjetjet e përfuara nga sondazhet dhe pyetësorë e studentëve apo grupet e interesit. Gjithashtu NJSBC përdor

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 53

Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	dhe të dhëna të tjera si testimet paraprake, provimet e studentëve, vlerësimin e detyrave etj (Shtojca 3.7). Evidenca që i referohet GVB (Shtojca 3.7) titullohet "Raport vjetor i NJSNC Fakulteti i Bujqësisë", por që në fakt përmbledh 3 raporte në vite të ndryshe akademike të vlerësimit të brendshëm për programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Bujqësisë, dhe jo një analizë e mirëfilltë e programeve të studimit, përfshi këtu dhe "CSU".			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Prandaj GVJ rekomandon kryerjen e analizave të veçanta dhe jo në grup të programeve të studimit, në të gjithë elementët e tij, duke përdorur të gjitha burimet e mundshme të informacionit, si dhe mendimet e sugjerimet që mund të përftoheshin nga studentët, stafi akademik, alumni, etj. Këto vlerësimeve duhet të jenë analitike e krahasuesenë funksion të përmirësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Për sigurimin e cilësisë përdoren burime të ndryshme si përfshirja e personelit akademik, ndihmës, kontrollet e ndryshme ushtruar nga autoritetet drejtuese apo NJSBC (RVB fq 50). GVJ konstaton se këto procese apo mekanizma nuk janë të dokumentuara. Këshilli studentor i UNiKO bëhet pjesë e takimeve informuese për "Sondazhin Kombëtar të Studentëve" organizuar nga ASCAL dhe BA.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Veprimtaria e Sektorit të Kurikulave Vlerësimit Institucional dhe Alumni realizohet sipas një plani dhe kalendari të caktuar i cili ndiqet nga NJSBC (Shtojca 3.22). NJSBC kryen vlerësimin e veprimtarisë akademike, kërkimore të stafit, por edhe të veprimtarisë administrative (Shtojca 3.7). GVJ konstaton se nuk ka instrumenta matës dhe vlerësues për ecurinë e programit të studimit. Analiza e referuar në GVB (Shtojca 3.7) nuk përfshin elementë të tillë matës, apo analitikë dhe krahasues.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Në GVB listohen disa nga problematikat që kanë dalë nga pyetësorët dhe sondazhet e studentëve, por kjo nuk mbështetet me raporte konkrete të
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre	

vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>analizave. Skedat (3.13 dhe 3.14), sigurisht janë të paplotësuara, pra që tregojnë përmbytjen e pyetësorëve, por rezultatet, analiza e tyre, raportet e hartuar mbi bazë të rezultateve dhe analizës së kryer mungojnë.</p> <p>Raporti të cilit i referohet GVB, nuk përmban rezultate të vlerësimit, apo masa të marra për adresimin e mangësive për përmirësimin e cilësisë.</p>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë				
Shkalla e përmbytjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Programi i studimit vlerësohet përmes indikatorëve të ndryshëm siç mund të jenë statistikat e punësimit të të diplomuarve (Shtojca 3.12), raportet e vetëvlerësimit të Fakultetit.</p> <p>NJSBC përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. (Shtojca 3.7).</p>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	NJSBC harton raporte periodike (Shtojca 3.7). Në këtë raport periodik nuk dalin të qarta cilat janë rezultatet e përfuara nga rrugët e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të	

provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Programet e studimit realizohen në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin përkatës. Programi i studimit përmirësohen në mënyrë të vazhduar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në dispozicion të studentëve vihet orari mësimor në fillim të çdo semestri.</p> <p>IAL i kushton rëndësi formimit praktik të studentëve, përmes një infrastrukture të mirë laboratorike, për zhvillimin e praktikave mësimore. Gjithashtu studentëve u mundësohet formimi praktik pranë bizneseve apo kompanive të ndryshme, që mundësohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit midis IAL dhe këtyre institucioneve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 56

dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Praktikat profesionale të studentëve mbikqyren nga stafi akademik i DAGU. Programi i studimit vlerësohet dhe analizohet në mënyrë periodike, siç u përmend më sipër. Kriteret e diplomimit janë të përcaktuara në rregullore, si dhe me vendim senati përcaktohet pragu i notës mesatare për ata studentë të cilët do të mbrojnë tezën e diplomës, si dhe për ata që i nënshtrohen provimit të diplomës. Në RVB fq. 53, shpjegohet se programi i studimit i është nënshtruar vlerësimeve periodike dhe si edhe përmirësimit të vazhdueshëm. Për GVJ nuk del e qartë se si veprohet për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, apo si realizohet përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm në përmirësimin e programit të studimit.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.				
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të	Sektori i Kurrikulës vlerësimin institucional dhe Alumni është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UNIKO-së, brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional dhe përfshin “Zhvillimin e Programeve Mësimore” dhe “Vlerësimin Institucional” (Shtojca 1.5). Departamenti vlerëson në mënyrë periodike punën mësimore dhe shkencore

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 57

interesuarit.	<p>dhe ia përcjel NJSBC (Shtojcat 3.7; 2.4). Për GVJ nuk rezultojn që rezultatet e vlerësimit të jenë bërë publike. Gjithashtu puna e pedagogëve vlerësohet dhe nga studentët përmes anketimeve të ndryshme, apo përmes përfshirjes së tyre në Sondazhin Kombëtar të studentëve të organizuar nga ASCAL dhe BA.</p> <p>Në RVB (fq. 54) raportohet se departamenti gjatë kryerjes së analizave vjetore, rekomandon detyra që duhet të ndiqen nga NJSBC. Për GVJ nuk rezultojn të evidentohen rekomandime apo të jetë hartuar një plan masash për kapërcimin e mangësive apo pikave të dobta që ndeshen gjatë procesit mësimor.</p> <p>GVB raporton se vlerësimi i pedagogëve kryhet edhe nëpërmjet plotësimit periodik të formularit të vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore (RVB fq. 54). GVJ nuk e konstatoi një vlerësim të tillë dhe rekomandoi pasqyrimin e vlerësimeve të tilla në raporte të veçanta ose si pjesë të analizës vjetore.</p> <p>GVJ rekomandon që rezultatet e vlerësimit të programit të studimit të bëhen publike, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.				
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.				
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			√	

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional
“Cilësia dhe Siguria UShqimore” të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë**

Pikat e forta dhe afirmime

1. Infrastrukturë bashkëkohore për një zhvillim normal të punës, mësimore dhe kërkimore-shkencore në Departament.
2. Staf me moshë relativisht të re, i përkushtuar për tu kualifikuar dhe për të mbështetur studentët.
3. Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar, pjesëmarrja në projekte dhe trajnime të ndryshme.
4. Bashkëpunim i gjerë me aktorë të ndryshëm të biznesit.
5. Organizimi i mirë i praktikave profesionale të studentëve në fushat e bujqësisë dhe agro-përpunimit.

Pika të dobta

1. Faqja zyrtare e web e institucionit nuk është aktive.
2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit nuk është aktiv.
3. Mospërfshirje e studentëve në praktika laboratorike.
4. Biblioteka dixhitale on-line në shërbim të studentëve dhe stafit nuk është aktive.

Rekomandime

1. Të aktivizohet faqja zyrtare e institucionit, si rruga kryesore për dhënien e informacionit që lidhet me aktivitetet dhe veprimtarinë në tërësi të institucionit.
2. Të aktivizohet sistemi i brendshëm i administrimit të informacionit ESSE 3.
3. Të ofrohen mundësi për stafin dhe studentët në bibliotekat on-line, të lidhura me programin e studimit.
4. Të përfshihen orët laboratorike, në modulet e formimit profesional.
5. Të rriten orët e praktikës profesionale deri në 150 (6ECTS).
6. Të gjenden mekanizma të vlerësimit dhe të implementohen institucionalisht për të përmirësuar procesin e mësimdhënies
7. Të përditësohet literatura në përdorim, të reçohej në mënyrë të rregull dhe të panashme, përfshirë këtu edhe leksionet e shkruara në përdorim.
8. Të vendoset theksi tek kualifikimet profesionale më shumë se tek ato shkencore, si për stafin ashtu edhe për studentët mbështetur nga fakti që institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm biznese profesionale.
9. Të kryhen analiza, vlerësime analitike e krahasuese, specifike dhe jo në grup të programeve të studimit, në të gjithë elementët e tyre, duke përdorur të gjitha burimet e mundshme të informacionit, si dhe mendimet e sugjerimet që mund të përftohen nga studentët, stafi



akademik, alumni etj., në funksion të përmirësimit të cilësisë. Vlerësimet duket të dokumentohen të përfshijnë rezultatet të pritshme, rezultate të vlerësimit, si dhe plan masash për adresimin e mangësive.

10. Të bëhen publike rezultatet e vlerësimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale të përfshijë rezultatet.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle, Professional Master in "Quality and Safety Food" of the University "Fan S. Noli", Korça

Strengths and affirmations


1. Contemporary infrastructure, appropriate for a normal research and teaching activities of the Department.
2. Academic staff is of a rather young age, committed to be highly qualified and to support the students.
3. National and international collaboration, project participation and continuous staff training.
4. Broad collaboration with business actors.
5. Appropriate practical training of the students in the field of agriculture and agriprocessing.

Weakness

1. Official website of institution is inactive.
2. Internal system of information management is inactive.
3. The lack of laboratory practices for the students.
4. Digital library on-line in the service to the students and academic staff is not active.

Recommendation

1. The official website of the institution must be available, since it is the main source to provide information relating to the activities of the institution.
2. The internal system of information management must be active.
3. The academic staff and students need to have access in the online libraries with sources of information and literature related to the study programme.
4. The laboratory hours must be included in the modules of professional education.
5. The load of practical training must be increased to 150 hours (6ECTS).
6. Additional evaluation mechanisms must be applied in order to improve the teaching process
7. The literature need to be updated, reviewed in an equal and continuous way, considering the lecture notes as well that are in use by the students.



8. More effort must be done for the professional qualification of academic staff and students compared to the scientific one. These are easily realizable, since the Institution has many partnership agreements with professional businesses.
9. The analysis, analytical and comparative evaluation must be individual, e.e, at the level of study programme, in all elements, using all sources of information, opinions and suggestions obtained by the students, academic staff, alumni etc for the sake of quality improvement. The evaluation results must be documented, and must include the expected results, results of evaluation, as well as a plan for improvement of weak points.
10. The evaluation results must be public, respecting the academic freedom and ethics, as well as the legal framework for the personal data.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				√
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			√	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			√	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			√	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				√
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			√	
VLERËSIMI TËRËSOR			√	